

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5569
E enjte, 6 shtator 2018
çmimi 0.40 €

Thaçi: Nuk do të bisedojmë
kurrë për veriun dhe
liqenin e Gazivodës | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", RAIF QELA | FAQE 4-5

Kosova Lindore është injoruar gjatë

Anëtari i Kryesisë së Lëvizjes për Bashkim (LB), Raif Qela, ka vlerësuar se formimi i ekipit negociator dhe përbërja e tij nuk janë garanci se vazhdimi i bisedimeve në këtë mënyrë do të ketë sukses. Ai ka thënë se formimi i këtij ekipi ka për qëllim mbajtjen e stabilitetit të Qeverisë, por jo zgjidhjen e problemit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Qela ka deklaruar se pozicionimi i pjesës më të madhe të skenës publike kundër

ndryshimit të kufijve do t'i bëjë dëm të pariparueshëm të ardhmes së vendit. Sipas tij, deputetët s'kanë të drejtë t'ua mbyllin shpresën shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës që t'i gëzojnë liritë që sot nuk i kanë. Ish-deputeti Qela ka pohuar se Kosova duhet të synojë ta zgjidhë problemin e shqiptarëve në Luginë të Preshevës pasi, sipas tij, kjo çështje është injoruar gjatë



AKTUALE

ÇERÇILLI,
GËRVALLA DHE...
LALA | F. 11



Nga Bedri ISLAMI

LIDERËT EVROPIANË IA
MËSYJNË SHKUPIT NË PRAG
TË REFERENDUMIT | F. 2

I DËRGUARI I TRUMPIT
VIZITON BALLKANIN JAVËN
E ARDHSHE | F. 2

FSK-ja E GATSHME PËR
PROCESIN E TRANZICIONIT
NË USHTRI | F. 7

EKONOMI

SFIDË E KOSOVËS, IKJA E TË
RINJVE NË PERËNDIM | F. 9

KULTURË

LUGINASIT
BRENDA
NJË LIBRI
MONOGRAFIK | F. 13



Bilall MALIQI

RECENSION I LIBRIT MË
TITULL: 'ÇESHTJA SHQIPTARE
PËRBALLË DIPLOMACISË DHE
GJEOPOLITIKËS RUSOMADHE
(1856-2018)' | F. 12

Prof. dr. Haxhi
FERATI



SPORT

KOSOVA SHKON PËR FITORE
NË AZERBAJXHAN | F. 16

61-shi, i zorshëm për pozitën dhe opozitën

Dy seancat e jashtëzakonshme të thirrura, njëra nga pozita e tjetra nga opozita, nuk po mund të mbahen për shkak se asnjëra palë nuk po arrin t'i mbledhë në sallën e seancave 61 deputetë. Kryeministri Ramush Haradinaj ka pranuar se, pos opozitës, as Lista Serbe, që është partnere e koalicionit, nuk po e voton propozimin e tij për ekipin negociator të Qeverisë për dialogun me Serbinë. Ndërsa as opozita nuk ka arritur t'i mbledhë 61 vota për seancën që kishte thirrur me qëllim të votimit të një rezolute që ndalon negociimin për kufij në dialogun me Serbinë, edhe pse të pranishëm ishin edhe deputetët e Nismës



SBASHK-u
paralajmëron
protestë nëse
nuk korrighohet
Projektligji
për pagat | FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

I dërguari i Trumpit viziton Ballkanin javën e ardhshme

WASHINGTON, 5 SHTATOR - Senatori amerikan dhe kryesuesi i Komisionit për Siguri Kombëtare i Senatit të Shteteve të Bashkuara, Ron Johnson, do ta vizitojë javën e ardhshme Kosovën, Greqinë, Maqedoninë

dhe Serbinë, konfirmoi për Shërbimin e Ballkanit të Radios Evropa e Lirë Ambasada Amerikane në Beograd. Johnson, gjatë turneut në Ballkan, do të takohet me udhëheqësit rajonalë, tha

ambasada. Ai është një nga bashkëpunëtorët e lartë të presidentit amerikan Donald Trump, i ngarkuar me misione të posaçme. Vizita e tij vjen në kohën kur

Kosova dhe Serbia po shqyrtojnë idenë e ndryshimit të kufijve, ndërsa këshilltari për Siguri Kombëtare në Shtëpinë e Bardhë, John Bolton, ka thënë se ShBA-ja nuk i përjashton korrigjimet territoriale.



Liderët evropianë ia mësyjnë Shkupit në prag të referendumit

"Ardhja e tre liderëve evropianë është mirënjohje për Maqedoninë, sinjal pozitiv. Ata po na e shtrijnë dorën që të ecim përpara", ka deklaruar kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, duke komentuar vizitat e tyre



SHKUP, 5 SHTATOR - Bashkimi Evropian po shton aktivitetet në mbështetje të Maqedonisë për referendumin e 30 shtatorit për Marrëveshjen me Greqinë, që parasheh zgjidhjen e kontestit të emrit. Me këtë marrëveshje zhbllkohet procesi i anëtarësimit të Maqedonisë në NATO dhe Bashkimin Evropian, pasi me zgjidhjen e çështjes së emrit Greqia më nuk do t'i vendosë veto Maqedonisë për inkuadrimit në këto dy organizata.

Të mërkurën në mbrëmje në Shkup pritet të arrijë sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, të premtën kancelari austriak Sebastian Kurz, ndërsa të shtunën kancelarja gjermane Angela Merkel, vizita e së cilës vlerësohet historike për autoritetet e Maqedonisë. "Ardhja e tre liderëve botërorë është mirënjohje për Maqedoninë, sinjal pozitiv. Ata

po na e shtrijnë dorën që të ecim përpara", ka deklaruar kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, duke komentuar vizitat e përfaqësuesve të lartë evropianë. Sipas tij, edhe opozita duhet të jetë e vetëdijshme se tani është çasti për BE-në dhe NATO-n kur, sipas tij, "të gjithë duhet të jemi të bashkuar për arritjen e qëllimit për inkuadrimit e vendit në strukturat euroatlantike".

Gjermania konsiderohet një nga shtetet që më së shumti ka mbështetur zgjidhjen e kontestit të emrit me Greqinë si dhe procesin e anëtarësimit të Maqedonisë në NATO dhe BE. Steffen Seibert, zëdhënësi i kancelares gjermane, ka thënë se në fokus të vizitës së Angela Merkel do të jenë "zhvillimet rajonale dhe çështjet bilaterale" dhe se kancelarja gjermane, sipas tij, "dëshiron që personalisht ta krijojë përshtypjen, në

vigjilje të referendumit, për çështjen e emrit që do të mbahet në fund të muajit".

Vizita e sekretarit të përgjithshëm të NATO-s është e dyta brenda këtij viti. Jens Stoltenberg edhe kësaj radhe pritet ta rikonfirmojë mbështetjen e Aleancës që Maqedonia të bëhet shteti i 30-të i saj, por që kjo të bëhet kreu i Aleancës do të kërkojë që referendumi të ketë sukses. "Nuk mund të jeni anëtare e NATO-s pa zgjidhur çështjen e emrit. Kjo u takon njerëzve të Maqedonisë të vendosin (në referendum). Qartë e kemi thënë se do t'i nisni bisedimet, por se duhet t'i zbatoni të gjitha obligimet nga

Marrëveshja me Greqinë, dhe më pas IRJM-ja do të bëhet anëtare e 30 e NATO-s, me emrin Republika e Maqedonisë së Veriut", ka deklaruar Stoltenberg.

Mbështetje për referendumin Maqedonia ka marrë edhe nga Austria, e cila aktualisht kryeson Bashkimin Evropian. Edhe pse në opinion njihet si mbështetës i politikave të qeverisë së ish-kryeministrit Nikolla Gruevski, tani kancelari austriak Sebastian Kurz qartë ka bërë me dije se mbështet Marrëveshjen e Prespës, ndërsa gjatë vizitës së fundit në Vjenë të kryeministrit aktual Zoran Zaev ka thënë se "marrëveshja

paraqet hap vendimtar në procesin e afrimit të Maqedonisë në Bashkimin Evropian".

Denko Maleski, profesor në Universitetin e Shkupit dhe ish-ministër i Punëve të Jashtme, thotë se interesi i Perëndimit për suksesin e referendumit dhe afrimin e vendit drejt NATO-s dhe BE-së ka të bëjë me dy faktorë. Së pari ka të bëjë me, siç thotë, "momentin unik historik i cili duhet të shfrytëzohet" e që, sipas tij, lidhet me interesat e vendeve të Perëndimit për uljen e ndikimit rus në Ballkan. "Kjo është shumë me rëndësi që të kihet parasysh pasi më herët nuk kishte një interesim kaq të madh të ShBA-së dhe BE-së për zgjerimin e NATO-s me Maqedoninë dhe shtetet e tjera të Ballkanit", thotë Maleski.

Ndërsa si faktor të dytë për interesimin e tyre në rritje për Maqedoninë, ai sheh pamundësinë e vendit që tani 30 vjet ta zgjidhë kontestin me Greqinë, andaj edhe angazhimi i tyre, sipas Maleskit, është në drejtim të mbylljes së këtij problemi që ka bllokuar edhe integrimin euroatlantik.

Bota nderon Nënë Terezën

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Humanistja me origjinë shqiptare Nënë Tereza është kujtuar të mërkurën në shumë vende të botës. Një sërë aktivitetesh në përkujtim të saj janë mbajtur në Kalkuta dhe Vatikan, ku ajo u shenjtërua dy vjet më parë.

Në përvjetorin e 21-të të vdekjes së shenjtore Nënë Tereza e gjithë bota ka kujtuar misionaren dhe fituesen e Çmimit Nobel për Paqen për dedikimin e saj ndaj të varfërve dhe të sëmurëve.

Lutje të veçanta janë mbajtur për ta rikujtuar në Kalkuta të Indisë, ndërsa qytetarë dhe murgësia kanë nderur qirin dhe kanë vendosur lule në "Mother House", e cila është edhe selia globale e Misionarëve të Bamirësisë (MoC),



e krijuar prej shenjtore në vitin 1950.

Edhe Kisha Katolike në Indi mbajti një meshë të mërkurën paradite në nder të Nënë Terezës. Adhures të shumë dhe besimtarë katolikë kanë kujtuar

shenjtoren të mërkurën edhe në Vatikan, aty ku Papa Françesku e shpalli "Shën Tereza e Kalkutës" dy vjet më parë. Edhe mediet ndërkombëtare i kanë dhënë gjerësisht hapësirë të veçantë përkujtimin të Nënë Terezës.

Lirohet nga detyra ministri i Tregtisë, Bajram Hasani

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë i Kosovës, Bajram Hasani, u lirua nga detyra. Këtë vendim e mori Qeveria e Kosovës me kërkesë të partisë së tij Nisma Socialdemokrate e Kosovës.

Zëdhënësja e Qeverisë, Donjeta Gashi, ka treguar se Nisma Socialdemokrate e Kosovës ka kërkuar nga kryeministri Ramush Haradinaj që ta lirojë nga detyra Bajram Hasanin. Arsyet e këtij vendimi nuk janë ende të qarta.



Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur tryezën "Çfarë do të thotë korrigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?"

Thaçi: Nuk do të bisedojmë kurrë për veriun dhe liqenin e Gazivodës

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, është shprehur i bindur se në bisedimet me Serbinë nuk do të flitet për veriun e vendit dhe për liqenin e Gazivodës. Në një tryezë të organizuar nga shoqëria civile, ai ka mohuar mundësinë që në fazën finale të dialogut me Serbinë të diskutohet ndarja e Kosovës, shkëmbimi i territoreve apo krijimi i "Republika Srbskës" brenda territorit të Republikës së Kosovës



proceset që garantojnë paqe dhe siguri në Kosovë dhe në tërë Evropën Juglindore", ka thënë Thaçi.

Në këtë tryezë Thaçi ka rithek-suar se arritja e marrëveshjes për normalizimin e raporteve me Serbinë do t'ia hapte Kosovës rrugën e integritimit në Bashkimin Evropian dhe NATO, si dhe anëtarësimin në Kombet e Bashkuara (OKB). "Si Kosovë kemi ndërtuar marrëdhënie të shkëlqyera me Malin e Zi, Maqedoninë dhe Shqipërinë. Si vende fqinje na mbetet të ndërtojmë marrëdhënie të mira fqinjësore me Serbinë, prandaj jemi angazhuar në dialog me Serbinë tani e sa vite. Është koha tani për marrëveshje të madhe historike përfundimtare mes dy shteteve", është shprehur Thaçi.

Në fillim të hapjes së tryezës, Ismet Kryeziu, drejtor ekzekutiv i KDI-së, ka bërë një vlerësim të përgjithshëm të procesit të dialogut duke ngritur disa çështje aktuale rreth procesit përmes pyetjeve: A janë zgjedhjet opsioni i vetëm që të arrihet unifikimi i qëndrimeve për dialog?; Se cili do të jetë roli i presidentit në raport me ekipin e propozuar nga Qeveria?; Korrigjimi gjithmonë vjen si pasojë e një gabimi, a është shpallja e Kosovës republikë në kufijtë aktualë një gabim?; A ka një analizë se çka mund të humbim apo fitojmë nga ky korrigjim?; Çka do të kemi në tryezë të diskutimit në Bruksel më 7 shtator?; Ideja e korrigjimit a është zgjedhje e jona apo çështje e sponsorizuar nga faktor ndërkombëtar?

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se në fazën finale të dialogut me Serbinë nuk do të bisedojë për liqenin e Gazivodës (Ujmani) e as për pjesën veriore të Mitrovicës. Në tryezën "Çfarë do të thotë korrigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?", të organizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ai ka thënë se nuk do të ketë ndarje dhe as shkëmbim të territoreve. "Çfarë do të thotë kjo? E para nuk do të ketë ndarje të Kosovës. Nuk do të ketë shkëputje të pjesës veriore të

Kosovës. Nuk do të ketë Sërpska Republikë në Kosovë. E kam thënë më parë dhe e them përsëri, nuk do të bisedojmë kurrë, në asnjë rrethanë, për liqenin e Gazivodës (Ujmanit) apo për qytetin e Mitrovicës", ka thënë Thaçi.

Ai ka deklaruar se tani është koha për marrëveshjen e madhe, historike, përfundimtare, në mes dy shteteve.

Është momenti i fundit, sipas presidentit, që të gjithë të ulen së bashku dhe ta dëgjojmë njëri-tjetrin pa paragjykimë. "Vëmendja e bashkësisë ndërkombëtare është përqendruar në arritjen e një marrëveshjeje në mes dy shteteve

tona si asnjëherë më parë në vitet e fundit", ka thënë ai, duke shtuar se është e rëndësishme që të shfrytëzohet ky rast dhe të arrihet kjo marrëveshje.

I pari i vendit është shprehur se njohja reciproke në mes të dy shteteve do të mund të përcillet edhe me një proces në mes të dy palëve për korrigjimin e kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Korrigjimi i kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë, sipas presidentit Thaçi, do ta shënonte fundin e konfliktit të gjatë mbi një shekull në mes të Kosovës

dhe Serbisë, e jo fillimin e një konflikti të ri. Thaçi ka thënë se një marrëveshje e tillë do të jetë kontribut për paqen dhe stabilitetin e kësaj pjese të Ballkanit dhe se nuk do të ketë pasoja në karakterin shumetnik të shoqërisë së Kosovës.

Në këtë kontest, ai ka shtuar se do të ruhet katalogu i të drejtave të pakicave dhe trashëgimia kulturore dhe fetare serbe në Kosovë. Shefi i shtetit ka vlerësuar se nëse e humbasim këtë rast, pas zgjedhjeve të BE-së që do të mbahen në pranverën e ardhshme, ekziston rreziku që Kosova dhe rajoni të gjenden përballë një BE-je edhe më të mbyllur për Ballkanin. "Është e rëndësishme të shfrytëzojmë këtë rast dhe të arrijmë këtë marrëveshje. Nëse e humbasim këtë rast pas zgjedhjeve të institucioneve të Bashkimit Evropian që do të mbahen në pranverën e vitit të ardhshëm rrezikojmë të gjendemi si Kosovë dhe si rajon përballë një Bashkimi Evropian më të mbyllur për Ballkanin Perëndimor. Rrjedhimisht do të kemi më pak vëmendje dhe vendosmëri për t'i shtyrë përpara



61-shi, i zorshëm për pozitën dhe opozitën

Dy seancat e jashtëzakonshme të thirrura, njëra nga pozita e tjetra nga opozita, nuk po mund të mbahen për shkak se asnjëra palë nuk po arrin t'i mbledhë në sallën e seancave 61 deputetë. Kryeministri Ramush Haradinaj ka pranuar se, pos opozitës, as Lista Serbe që është partnere e koalicionit nuk po e voton propozimin e tij për ekipin negociator të Qeverisë për dialogun me Serbinë. Ndërsa as opozita nuk ka arritur t'i mbledhë 61 vota për seancën që kishte thirrur me qëllim të votimit të një rezolute që ndalon negociimin për kufij në dialogun me Serbinë, edhe pse të pranishëm ishin edhe deputetët e Nismës

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Është shtyrë përsëri të mërkurën seanca e thirrur nga Qeveria për votimin e ekipit negociator, i propozuar nga kryeministri Ramush Haradinaj. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, pas fillimit të seancës

së jashtëzakonshme me katër orë vonesë, ka thënë që nuk ka kuorum për votimin e ekipit negociator të Qeverisë për dialogun për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi. "Me aq sa mund ta konstatoj nga administrata, nuk ka kuorum, për këtë arsye vazhdimi i seancës do të bëhet kur të ketë kuorum", ka

bërë me dije Veseli. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pranuar që as Lista Serbe nuk po e voton propozimin e tij për ekipin negociator. Ai nuk ka dhënë ndonjë informacion nëse do të ketë vazhdim të seancës, por ka theksuar se ajo që dihet botërisht është se opozita dhe Lista Serbe nuk e votojnë

ekipin negociator. Shefi i Grupit Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, ka thënë se shtyrja e seancës së thirrur nga Qeveria po bëhet sa për ta vjedhur kohën e opozitës për seancën e thirrur nga ta. "Kjo shtyrje që nuk po përfundon kurrë është sa për ta vjedhur kohën e opozitës për seancën e thirrur. Me fjalë të tjera, kemi të bëjmë me një veprim të qëllimshëm që po i shërben edhe kryetari i Kuvendit, që çdo dy orë ta shtyjë seancën, në mënyrë që Hashim Thaçi të shkojë në takim me Vuçiqin dhe ai të mos ketë asnjë pengesë", ka thënë Konjufca. Qeveria ka marrë vendim që

zëvendëskryeministri Fatmir Limaj do të jetë shefi i ekipit negociator në bisedimet me Serbinë, ndërsa zëvendëskryesues i këtij ekipi do të jetë zëvendëskryeministri tjetër, Enver Hoxhaj. Anëtarë të ekipit negociator do të jenë edhe Behgjet Pacolli, Dardan Gashi, Avni Arifi dhe Mahir Jaghillari. Edhe partitë opozitare në seancën e thirrur me qëllim të votimit të një rezolute që ndalon negociimin për kufij në dialogun me Serbinë nuk kanë arritur të mbledhin 61 deputetë për të siguruar kuorum për votim të kësaj rezolute. Në seancën e opozitës ishin edhe deputetët e grupit parlamentar të Nismës Socialdemokrate.

Flet për "Epokën e re", Raif Qela

Kosova Lindore ës

Anëtari i Kryesisë së Lëvizjes për Bashkim (LB), Raif Qela, ka vlerësuar se formimi i ekipit negociator dhe përbërja e tij nuk janë garanci se vazhdimi i bisedimeve në këtë mënyrë do të ketë sukses. Ai ka thënë se formimi i këtij ekipi ka për qëllim mbajtjen e stabilitetit të Qeverisë, por jo zgjidhjen e problemit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Qela ka deklaruar se pozicionimi i pjesës më të madhe të skenës publike kundër ndryshimit të kufijve do t'i bëjë dëm të pariparueshëm të ardhmes së vendit. Sipas tij, deputetët s'kanë të drejtë t'ua mbyllin shpresën shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit e Medvegjës që t'i gëzojnë liritë që sot nuk i kanë. Ish-deputeti Qela ka pohuar se Kosova duhet të synojë ta zgjidhë problemin e shqiptarëve në Luginë të Preshevës pasi, sipas tij, kjo çështje është injoruar gjatë

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 5 SHTATOR -

"Epoka e re": Z. Qela, ka qenë veprim i duhur i Qeverisë së Kosovës formimi i ekipit negociator të udhëhequr nga zëvendëskryeministri Fatmir Limaj? Prisni që ky ekip ta marrë aprovimin e Kuvendit të Kosovës?

Qela: Si shumica e veprimeve të ndërmarra nga institucionet e Kosovës, edhe ky është një veprim i ndërmarrë me nguti, i papeshuar mirë, që ka për qëllim mbajtjen e stabilitetit të Qeverisë, por jo edhe zgjidhjen e problemit. Në vend se t'i artikulonin qartë detyrat imediate për të dalë nga kjo situatë, ata merren me vogëlsira se kush do të jetë në delegacion të bisedimeve e kush jo. Dhe këtë e bëjnë jo se e kanë bindjen se po veprojnë në interes të Kosovës, por se duke e ditur qëndrimin e opinionit publik, të pasqaruar e të hutuar, me kokëfortësi i shtynjë përpara vetëm pikëpamjet që mund t'u ndihmojnë për përfitim të votave nesër. Me këtë logjikë po punon pozita dhe opozita, për fat të keq. Detyra më e ngutshme e kësaj Qeverie, e Kuvendit, e presidentit dhe e të gjitha forcave politike në vend duhet të jetë hartimi i një platforme politike për zgjidhjen përfundimtare të problemeve me Serbinë dhe arritja e një kompromisi rreth kësaj platforme. Formimi i ekipit negociator, e as përbërja e tij, nuk janë kurrfarë garancie se vazhdimi i bisedimeve në këtë mënyrë do të kenë sukses. Përkundrazi! Pa platformë të qartë politike rreziku që të kemi pasoja nga këto bisedime të papërgatitura është shumë i madh. Për shkak të raportit të forcave në Kuvend, si dhe për shkak se edhe Lista Serbe mund të vazhdojë të bëjë obstrukcione duke kërkuar kundërshtim (ashtu siç e ka zakon), ka gjasa që Kuvendi të mos mund ta bëjë kuorumin as për këtë seancë, as për

tjetrën të iniciuar nga opozita.

"Epoka e re": Që dy ditë deputetët opozitarë janë duke bërë përpjekje të mbajnë një seancë të jashtëzakonshme në të cilën pretendohet të miratohet rezoluta kundër ndryshimit të kufijve të shtetit të Kosovës. Çfarë epilogu prisni nga kjo seancë?

Qela: Nëse mbahet dhe nëse arrijnë t'i bëjnë votat për diçka të tillë, ky do të jetë një turp i madh për krejt Kuvendin. Po e shfrytëzoj rastin t'u drejtohem edhe një herë ish-kolegëve të mi, deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Do të bëjnë gabim të madh nëse ata ia mbyllin rrugën vetes, duke votuar një rezolutë për të cilën do të pendohen më vonë. Nëse duan të jenë të matur, rezoluta do të duhej të përmbajë vetëm parimin bazë për bisedimet: reciprocitetin në të drejta ndërmjet tri komunave me shumicë dërrmuese serbe në veri të Kosovës (Leposaviq, Zubin Potok e Zveçan) dhe tri komunave me shumicë shqiptare nën Serbi: Preshevë, Bujanovc e Medvegjë. Respektivisht, reciprocitetin në të drejta ndërmjet të drejtave të serbëve në Kosovë me ato të shqiptarëve në Serbi. Dhe kjo rezolutë do ta kanalizojë udhën që do të shtrohet edhe e drejta e shpëputjes, respektivisht e ndryshimit të kufijve në një të ardhme të afërt. Kufijtë nuk janë të shenjtë. Ata kanë ndryshuar në faza të ndryshme të historisë. Dhe për shqiptarët janë të padrejtë. Ne duhet të synojmë ta zgjidhim problemin e shqiptarëve në Serbi andej nga janë shumicë dhe që kanë vazhdimësi territoriale me Kosovën. As Kushtetuta e Kosovës nuk është e shenjtë. Ajo ka plot të meta. Duke i akomoduar interesat e serbëve të Kosovës në llogari të krejt popujve të Kosovës, duke iu krijuar privilegje të skajshme serbëve, përmes vendeve të rezervuara në Kuvend, përmes së drejtës së votës së dyfishtë, përmes

Fondit të Veriut, e tani (në pritje) edhe përmes Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, kjo Kushtetutë është antidemokratike. Si pasojë e këtyre dispozitave diskriminuese, përfaqësuesit serbë në institucionet e Kosovës (që ata në thelb nuk i pranojnë!), mund ta bllokojnë shtetin e Kosovës kur të duan. Siç po e bllokojnë vazhdimisht. Prandaj, kjo Kushtetutë duhet të ndryshohet. Dhe mund të ndryshohet vetëm me një marrëveshje të re, gjithëpërfshirëse, përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Prandaj duhet të hiqen dispozitat e padrejta prej saj. Çdo çimentim i status quosë në këtë drejtim do të jetë në dëm të shqiptarëve. Pozicionimi skajshmërisht i paarsyeshëm, i palogjikshëm, si në kor, i pjesës më të madhe të skenës sonë publike kundër ndryshimit të kufijve, do t'i bëjë dëm të pariparueshëm së ardhmes së vendit tonë. Nuk është problem fare nëse me rezolutë Kuvendi e pengon presidentin Thaçi që të jetë në krye të negociatave. Por deputetët nuk kanë të drejtë t'ua mbyllin shpresën shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës që t'i gëzojnë liritë të cilat sot nuk i kanë.

"Epoka e re": Si e shihni vazhdimin e procesit të dialogut?

Qela: Varet prej seriozitetit të institucioneve tona. Është në interes të popullit shqiptar dhe të popullit serb që këto bisedime t'i kurorëzojnë me marrëveshje historike: duke i ripërcaktuar kufijtë në përputhje me të drejtën e kombeve për vetëvendosje, por edhe duke i marrë për bazë përfitimet e dyanshme. Kufiri do të lëvizte sipas vullnetit të deklaruar të popullatës në vija kufitare që kanë vazhdimësi me trungun amë (natyrisht, aty ku e kanë shumicën!) Natyrisht, duke i pasur parasysh disa interesa vitale. Kosova ka shumë më shumë interesa vitale në



Gazivodë sesa Serbia. Serbia ka interesa vitale që ta mbajë autostradën dhe hekurudhën e korridorit 10. Kosova nuk ka domosdo. Por edhe matanë këtyre dy objekteve ka vendbanime shqiptare. Kompaktësia e viseve shqiptare të quajtura si Kosovë Lindore nuk duhet të cenohet. Zgjidhja do të gjendej me kompromise në dobi të të dyja palëve; qasje të lirë në këto objekte vitale edhe për shqiptarët, edhe për serbët. Të dyja palët do të duhej të jenë largpamëse se nga kjo rrjedhë negociatash, përfitimi do të

jetë i madh për shqiptarët dhe serbët. Kështu do të ishte mirë të ndodhë. Por bisedimet nuk do të jenë të lehta. Nëse çimëtohet pozicioni i palës kosovare për mosndryshim të kufijve - pasojat do të jenë më të mëdhatë për ne. Do ta kemi asociacionin (me a pa kompetenca ekzekutive), i cili, i kombinuar me privilegje alla-Ahtisari, do ta bëjnë edhe më jofunksional shtetin e Kosovës saqë, pas një a dy dekadash, edhe kundërshtarët më të ashpër të ripërcaktimit (ridefinimit) të kufijve do të jenë të gatshëm t'ua falin veriun pa kom-

htë injoruar gjatë



gëzojnë të drejtën e bashkimit me Kosovën dhe duke e shikuar me mendje të kthjellët edhe çështjen e tri komunave serbe në veri. Në komunat Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan (pa shtatë fshatra shqiptare që kanë kompaktësi të pashkëputur territoriale me pjesën shqiptare) ka vetëm serbë që nuk duan t'u binden institucioneve të Kosovës. Këto territore Kosova realisht nuk i kontrollon dhe nuk do të mund t'i kontrollojë. Përmes përpjekjes për t'i mbajtur me dhunë, ne po ia gërryjmë vetes sovranitetin edhe ashtu të brishtë. Ne duhet të synojmë t'i mbajmë ata kufij që do të mund t'i kontrollojmë. Për ne duhet të jenë me rëndësi strategjike veriu i Mitrovicës dhe shtatë fshatrat shqiptare që ndodhen nën administrim të tri komunave serbe të veriut (Cerajë, Koshtovë, Bistricë, Boletin, Zhazhë, Lipë/Kelmend e Çabër). Këtu nuk duhet të ketë kompromis. Veriu është kancer për sovranitetin e Kosovës.

Kjo Qeveri është e papërgjegjshme

"EPOKA E RE": Lëvizja për Bashkim (LB) këtë herë nuk është përfshirë në Qeveri. Cili është vlerësimi juaj për këtë koalicion qeverisës?

Qela: Kjo Qeveri është e papërgjegjshme si të gjitha qeveritë e deritashme. Madje në disa segmente kjo Qeveri ua kalon të gjitha qeverive paraprake për veprime të kundërligjshme e arbitrare. Çka është më e keqja, ky koalicion qeverisës për shkak të numrave është krejt i varur prej votave të Listës Serbe, e cila e shantazhon Qeverinë dhe krejt Kosovën sa herë që të dojë. Kjo punë u pa edhe këto ditë. Por që të shkojë ky absurditet deri në fund, edhe opozita ia ndihmon Listës Serbe këtë faktorizim, duke bllokuar edhe procese që janë në dobi të vendit vetëm që të përfitojë politikisht. Sa për njoftim, Lëvizja për Bashkim, në bazë të marrëveshjes parazgjedhore me koalicionin qeverisës, i ka pasur të rezervuara vendet për një ministër dhe dy zëvendësministra por, nuk i ka pranuar, pikërisht për shkak se kjo Qeveri është krejt e varur prej votave të Listës Serbe.

pensim në Lindje vetëm po të mund t'i hiqim këto dispozita antidemokratike. Dhe nuk do të mund ta ndryshojmë Kushtetutën për asgjë: as për ushtrinë, as për Ligjin mbi festat zyrtare, as për plot ligje të tjera. Do të jemi krejtësisht të varur nga përfaqësuesit serbë në Kuvendin e Kosovës, siç po shihet kjo varësi edhe këto ditë në seancën e Kuvendit. Nëse pozicionohemi pro bisedimeve politike me platformë të qartë, me parimin bazë - reciprocitetin në të drejta, me unitet veprimi të krejt spektrit politik shqiptar, do të na hapet

rruga e njëmendtë për sovranitet të plotë, për përparim e zhvillim. Opinioni publik nuk është përgatitur pothuajse fare për këtë rrjedhë të bisedimeve. As në Kosovë, as në Serbi. Në Serbi vazhdon fryma nacionalshoviniste edhe në pushtet, edhe në opozitë. Është i dobët zëri i opozitës demokratike, por duhet të ecet në këtë drejtim. Dhe Kuvendi i Kosovës, Qeveria e subjektet politike, e kanë për detyrë t'ia trasojnë këtë udhë vetes. Jo t'ia mbyllin atë.

"Epoka e re": Sa mund të jetë e

realizueshme ideja e presidentit Thaçi për korrigjimin e kufirit me Serbinë duke pasur parasysh se ai po thotë se me këtë korrigjim do të përfitojë vetëm Kosova, pra Lugina e Preshevës do t'i bashkohet Kosovës, kurse Serbia nuk do të marrë asgjë?

Qela: Unë kam besim të plotë se nëse institucionet e Kosovës do ta shtrojnë këtë çështje drejt, duke u nisur nga parimi i reciprocitetit në të drejta, ky ndryshim kufijsh mund të bëhet. Dhe do të jetë në interes të të dyja palëve. Do të çlirohen nga robëria serbe vëllezërit

tanë në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Do të hiqen dispozitat bllokuese, antidemokratike nga Kushtetuta e Kosovës që burojnë nga Pakoja e Ahtisarit. Do të hapet rruga për sovranitet të njëmendtë të Kosovës, për përparim dhe zhvillim. Për integritet kombëtarë e ndërkombëtarë. Edhe Serbia do të ketë përfitime të shumëpritura. Do t'i hiqet nga barra Kosova dhe do t'i hapet rruga për integritet evropianë. Por kjo mund të bëhet vetëm duke e shtruar me guxim të drejtën e shqiptarëve të Luginës së Preshevës që ta

Gjykata Supreme thellon bashkëpunimin me Avokatin e Popullit

PRISHTINË, 5 SHTATOR (ER) - Kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, ka pritur të mërkurën në takim Avokatin e Popullit, Hilmi Jashari dhe zëvendësavokaten e Popullit, Edona Hajrullahun. Me qëllim të thellimit të bashkëpunimit në mes të Gjykatës Supreme dhe institucionit të Avokatit të Popullit, bashkëbiseduesit janë pajtuar të koordinohen lidhur me çështjet e të drejtave të njeriut, posaçërisht lidhur me opinionet Amicus Curiae, të cilat Avokati i Popullit ia

adreson gjyqësorit, në cilësinë e mikut të gjykatës.

Kryetari Peci ka vlerësuar lart angazhimin e Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave të njeriut, duke shprehur njëkohësisht gatishmërinë për bashkëpunim institucional mes dy institucioneve.

Ndërkaq Avokati i Popullit, Jashari, ka përmendur disa raste sfiduese, për të cilat ky institucion ka ndërmarrë hapat e nevojshëm, ka nxjerrë opinione për të ndihmuar Gjykatën Supreme në

çështje të caktuara, kur kjo e fundit përcakton qëndrime parimore dhe mendime juridike në çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat e Kosovës.

Bashkëbiseduesit u pajtuan të ndërmarrin hapa konkretë për luftimin e diskriminimit, për zbatim të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nga gjyqësori dhe në aspekte të tjera të ngjashme, të cilat ndikojnë në fuqizimin e sundimit të ligjit dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.



'Kawa Group' i bashkohet aksionit 'Ta pastrojmë Kosovën'

Kompania "Kawa Group" i është bashkuar fushatës së madhe "Ta pastrojmë Kosovën" e cila nis më 15 shtator dhe zgjatë tre muaj, deri më 15 dhjetor

EPOKA
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 5 SHTATOR - 'Let's Do It Kosova', 'Kawa Group' dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si bartëse e task-forcës për pastrimin e Kosovës, kanë nënshkruar të martën memorandum për ndërmarrjen e aksionit për pastrimin e deponisë më të madhe në Prishtinë që gjendet te Stacioni i Autobusëve. Iniciativa për pastrimin e deponisë më të madhe në Prishtinë dhe kthimin në park të gjelbëruar ka ardhur si kërkesë nga kompania 'Kawa Group' për 'Let's Do It Kosova'.

Drejtori ekzekutiv i 'Let's Do It Kosova', Luan Hasanaj, ka falënderuar kompaninë 'Kawa Group' për iniciativën për pastrimin e kësaj deponie. Edhe një herë ai u ka bërë thirrje të gjithëve që të bashkohen në aksionin e madh për pastrimin e Kosovës që do të fillojë më 15 shtator. "Sot bashkë po e përçojmë një



mesazh për nevojën e madhe të kontributit në shoqëri të sektorit të biznesit. Pas krijimit të Task Forcës nga Qeveria, është radha e qytetarëve të tregojnë përgjegjësi dhe ta ndihmojnë Qeverinë dhe të gjithë neve të tjerëve për pastrimin e Kosovës. Kjo që po ndodh sot me 'Kawa'-n është shembull që duhet të ndiqet nga të gjithë, sidomos në sektorin e ndërtimit, pasi një numër i madh i deponive ilegale të mbeturinave janë me mbetje ndërtimore. Ndonëse lokacionet për

këto mbetje ende nuk janë përcaktuar nga komunat. Kjo nuk nënkupton se bizneset kanë të drejtë ta dënojnë natyrën, por duhet bërë zgjidhje. U bëj apel të gjithëve të na bashkohen në këtë rrugëtim, sepse vetëm kështu mund ta bëjmë Kosovën të pastër", ka thënë Hasanaj.

Ndërsa ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka falënderuar kompaninë 'Kawa Group' dhe 'Let's Do It Kosova' që

do të jenë pjesë e aksionit për pastrimin e gjithë vendit. Ai ka apeluar tek të gjitha institucionet, kompanitë dhe qytetarët, që të jenë pjesë e aksionit për pastrimin e Kosovës.

Edhe pronari i kompanisë 'Kawa Group', Valon Vataj, ka bërë një thirrje që të gjitha kompanitë dhe qytetarët të marrin pjesë në aksionin e pastrimit. "I ftoj të gjitha kompanitë ndërtimore dhe qytetarët të bëhen pjesë e aktiviteteve për eliminimin e problemeve

mjedisore. Pa arritjen e një kulture evropiane nuk mund t'i tejkalojmë këto probleme. I ftoj qytetarët t'i bashkohen aksionit të madh për pastrimin e Kosovës i cili nis më 15 shtator", ka thënë Vataj.

Pas nënshkrimit të memorandumit, të gjithë u zotuan se bashkëpunimi mes tyre do të vazhdojë edhe më tej. 'Let's Do It Kosova' ka njoftuar se tashmë ka filluar edhe hartimi i deponive ilegale të mbeturinave në të gjithë Kosovën përmes aplikacionit "TrashOut".

Në UPZ nisi punimet konferenca për vlerësimin në edukim dhe psikologji

PRIZREN, 5 SHTATOR (ER) - Në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren ka nisur të mërkurën punimet Kongresi VI Ndërkombëtar mbi matjen dhe vlerësimin në edukim dhe psikologji, i cili do të mbahet nga 5 deri më 8 shtator. Në hapjen solemne kanë marrë pjesë rektori i UPZ-së, prof. dr. Ramë Vataj, në cilësi të nikoqirit, në emër të EPODDER prof. Selahattin Gelbal, në emër të HKU prof. Yaşar Ozbay, kryetari i Komunës së Prizrenit, prof. dr. Mytaher Haskuka, konsullja e Turqisë në

Prizren, Eylem Altunya, deputetët e Kuvendit të Kosovës, Müferra Srbica - Sinik dhe Fikrim Damka dhe mysafirë të shumtë.

Kongresi ka për qëllim ta ndajë ekspertizën, përvojën dhe punën shkencore me kolegët në mbarë botën. Kongresi do t'i përfshijë folësit e ftuar, diskutimet në panele, raportet verbale dhe prezantimet e posterave.

Rektori i UPZ-së, prof. dr. Ramë Vataj, ka vlerësuar të rëndësishëm veçantë mbajtjen e kësaj konference shkencore në UPZ. Ai ka theksuar se Turqia dhe univer-

sitetet turke janë mbështetësit më të mëdhenj të këtij universiteti që nga fillimi, duke shtuar se prej se ka ardhur rektor i UPZ-së bashkëpunimin me universitetet turke e ka konsideruar bashkëpunim kombëtar.

Kryetari i Komunës së Prizrenit, prof. dr. Mytaher Haskuka, ka thënë se ndihet i nderuar që merr pjesë në këtë konferencë të rëndësishme shkencore që po mbahet në qytetin e Prizrenit. Ai ka shtuar se Prizreni ka bashkëpunim të mirë me shumë komuna të Turqisë.



Shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Italisë, gjeneralletenant Salvatore Farina, pritet me ceremoni ushtarake në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK)

FSK-ja e gatshme për procesin e tranzicionit në ushtri

Shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Italisë, gjeneralletenant Salvatore Farina, gjatë takimit me zyrtarët qeveritarë të Kosovës dhe me drejtues të FSK-së, ka konfirmuar se Forcat e Armatosura të Italisë janë të gatshme që në vazhdimësi ta mbështesin Kosovën në sferën e sigurisë dhe zhvillimit të kapaciteteve të saj të sigurisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjeneralletenant Rahman Rama, ka pritur me ceremoni ushtarake të mërkurën në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura të Italisë, gjeneralletenant Salvatore Farina. Me këtë rast, ministri i FSK-së, Rustem Berisha, ka falënderuar gjeneralin Farina për angazhimin e vazhdueshëm dhe mbështetjen e pakursyer të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Italisë dhënë Kosovës, popullit, sigurisë dhe lirisë së saj. Berisha ka theksuar se falë mbështetjes së shteteve dhe forcave mike dhe partnere, FSK-ja ka arritur të zhvillohet profesionalisht, të jetë forcë e përfaqësuar nga të gjithë dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Më tej, ministri Berisha, duke i shprehur gjeneralit italian Farina gatishmërinë për bashkëpunim, ka shprehur interesimin dhe synimin që Ministria për FSK-në dhe Ministria e Mbrojtjes së Italisë sa më parë ta formatizojnë bashkëpunimin me marrëveshje ndërshtetërore. "Si FSK jemi të gatshëm që me disa prej kapaciteteve tona të kontribuojmë së bashku me partnerët tanë kudo ku paraqitet nevoja, në mënyrë që edhe Kosova të kontribuojë për paqe dhe sta-

bilitet ashtu siç shtetet mike kanë kontribuar për paqen dhe stabilitetin në atdheun tonë", ka thënë Berisha.

Ndërsa komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rahman Rama, ka thënë se FSK-ja është ngritur dhe zhvilluar në bashkëpunim dhe në mbështetje të partnerëve dhe miqve të Kosovës. "Neve na duhet edhe më tutje kjo mbështetje. Ne jemi në një fushatë intensive informuese dhe këshilluese të shteteve dhe të qendrave të rëndësishme evropiane mbi procesin e zhvillimit dhe të ardhmen e FSK-së për t'i informuar se udhëheqësit janë për të marrë vendime të vështira, por ne duam që këto vendime mos



ta befasojnë askënd", ka thënë komandanti i FSK-së, Rahman Rama.

Kryesuesi i delegacionit italian, gjeneralletenant Salvatore

Farina, në fjalën e tij ka thënë se Forcat e Armatosura të Italisë janë të gatshme që në vazhdimësi ta mbështesin Kosovën në sferën e sigurisë dhe

zhvillimit të kapaciteteve të saj të sigurisë. Në fund, gjenerali Farina ka theksuar se FSK-ja është dhe do të jetë faktor me rëndësi në rajon e më gjerë.

Edhe kryeministri e pret në takim gjeneralletenant Salvatore Farinën

"Është nder t'ju kemi sot. Shërbimi juaj në Kosovë është investim afatgjatë. Është e rëndësishme të jemi bashkë në të gjitha proceset për vendin dhe rajonin", kështu ka deklaruar kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, pasi ka pritur të mërkurën në takim shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura të Italisë, Salvatore Farina.

Haradinaj e ka njoftuar shefin e Shtabit, Salvatore Farina, për progresin që e ka bërë Kosova në proceset shtetndërtuese,

për progresin në ekonomi dhe në fuqizimin e rendit dhe ligjit, me theks të veçantë për gatishmërinë e FSK-së drejt tranzicionit të saj në ushtri, si një forcë profesionale, shumetnike dhe sipas standardeve të NATO-s dhe një forcë që do të rreshtohet krahas ushtrive të paqes, në ofrimin e paqes dhe sigurisë.

Kryeministri Haradinaj e ka falënderuar gjeneralin italian për kontributin dhënë gjatë shërbimit në Kosovë, si komandant i KFOR-it, duke i

kërkuar përkrahjen e mëtutjeshme të tij dhe të shtetit italian për procesin euroatlantik dhe proceset e tjera të rëndësishme për vendin. "Populli i Kosovës do të jetë përherë mirënjohës për përkrahjen dhe besimin që i keni dhuruar gjatë mandatit tuaj si udhëheqës i forcave paqeruajtëse në Kosovë dhe për mbështetjen e vazhdueshme që ka dhënë shteti i Italisë në të gjitha proceset shtetndërtuese dhe integruuese të vendit", ka thënë Haradinaj në takim, duke

theksuar se Qeveria është duke u angazhuar që ta fuqizojë partneritetin politik dhe ekonomik me Italinë, duke ofruar ambient të përshtatshëm për investimet direkte të huaja.

Kryeministri Haradinaj e ka nderuar gjeneralin Farina me medaljen e Skënderbeut, në nderim të kontributit të tij të dhënë, derisa ka pranuar nga Ushtria italiane medaljen e nderit si shenjë falënderimi për bashkëpunimin e deritashëm.

SBASHK-u paralajmëron protestë nëse nuk korrigohet Projektligji për pagat

EPOKA
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) ia ka bërë me dije kryeministrit Ramush Haradinaj dhe zyrtarëve të tjerë shtetërorë, se të shtunën do të mbajë një protestë nëse nuk korrigohet Projektligji për pagat. "SBASHK-u, duke dëgjuar zërin e punëtorëve të arsimit nga e tërë Kosova, do t'i nisë përgatitjet për veprime konkrete sindikale

duke filluar me një protestë të shtunën, më 8 shtator, para Qeverisë e për të vazhduar pastaj, nëse Qeveria nuk reflekton dhe nuk e kthen Projektligjin për korrigjim në Ministrinë e Administratës Publike, me veprime të tjera sindikale. Nga e hëna, kur Qeveria e Kosovës ka votuar Projektligjin për pagat, SBASHK-u ka bërë një analizë të tij dhe ka vërejtur se versioni i votuar që do të mbështesë me dhjetëra e dhjetëra milionë shtesë nga buxheti i Kosovës do ta mundësojë ngritjen e dukshme

të pagës për shumicën e sektorit publik, por jo edhe për sektorin e arsimit dhe atij të kulturës", është thënë në njoftimin e SBASHK-ut. Sipas njoftimit, ky projektligj është diskriminues, degradues dhe nënçmues ndaj të punësuarve në arsim dhe kulturë. "Për situatën e krijuar dhe për tensionet e ngritura në tërë sistemin arsimor SBASHK-u ka informuar me shkresa zyrtare kryeministrin Haradinaj, zëvendëskryeministrat Limaj, Hoxhaj e Pacolli dhe ministrin në MASHT-it, Shyqiri Bytyqi,



duke kërkuar nga ata të kthehet për korrigjim Projektligji për pagat, në të kundërtën në sis-

temin arsimor do të fillohen veprimet sindikale", është thënë në njoftimin e SBASHK-ut.



'Hello Tomorrow', mundësi ideale për rininë e Kosovës

PRISHTINË, 5 SHTATOR (ER) - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, dhe ambasadori i Republikës së Francës në Kosovë, Didier Chabert, kanë marrë pjesë në ngjarjen e përbashkët të prezantimit të sfidës ndërkombëtare për financimin e startupeve "Hello Tomorrow". Në fjalën e mbajtur në këtë ngjarje ministri Beqaj ka folur për rëndësinë e pjesëmarrjes së

të rinjve të Kosovës në këtë garë dhe ka shprehur kënaqësinë e tij për bashkëpunim me Ambasadën e Francës në Kosovë. "Trendët e globalizimit janë të orientuar drejt këtyre temave dhe po lëvizin me hapa të shpejtë. Edhe rinia e Kosovës është duke i ndjekur këta trendë. Kosova ka potencial të jashtëzakonshëm të jetë lidere e rajonit për inovacion dhe ndërmarrësi. Në këtë aspekt

Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar për zhvillim ekonomik, të bazuar në inovacion, rini, hulumtim dhe zhvillim, ekonomi të dijes, soft skills dhe teknologji të reja", ka thënë ministri Beqaj, duke shtuar se "Hello Tomorrow" është mundësi ideale për rininë e Kosovës për të përfituar nga rrjeti më i madh i teknologjisë. Ndërsa ambasadori i

Republikës së Francës në Kosovë, Didier Chabert, ka theksuar rëndësinë që është duke i dhënë Franca përkrahjes financiare në fushën e inovacionit dhe teknologjisë. "Kosova ka popullatën më të re dhe më të talentuar në Evropë. Jam entuziast dhe krenar të shoh shumë ndërmarrës nga Kosova të aplikojnë dhe të përzgjidhen në këtë garë", është shprehur ambasadori

Didier Chabert.

"Hello Tomorrow" ka nisur edicionin e pestë të Global Challenge, një garë e startupeve dedikuar ndërmarrësve të shkencës dhe teknologjisë që është hapur deri më 14 shtator. Gara është mundësi e mirë për të rinjtë e Kosovës për të përfituar nga rrjeti më i madh i teknologjisë duke takuar VC (Venture Capital) dhe grupe të mëdha të investitorëve.



AVONET-i vlerëson për performancë të mirë tri ministri

PRISHTINË, 5 SHTATOR (ER) - Rrjeti i OJQ-ve AVONET ka nxjerrë performancën e ministrive më të mira të qeverisjes Haradinaj. AVONET ka matur performancën e ministrive të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke monitoruar edhe punën e tyre, ndërsa tri nga të gjitha ministratë dalin me performancën më të mirë për këta muaj

të qeverisjes. Sipas AVONET, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka marrë disa vendime të rëndësishme gjatë kësaj periudhe. Vendim i rëndësishëm i kësaj ministrie sipas AVONET është edhe tarrasti i lodrave të fëmijëve ku ishte konstatuar si shumë i rrezikshëm për shëndetin e fëmijëve, me ç'rast është bërë edhe ndalimi i impor-

timit të këtyre lodrave. Rrjeti i këtyre organizatave si ministri me performancë të mirë ka renditur edhe atë të Shëndetësisë. "Në Ministrinë e Shëndetësisë janë pajisur disa klinika me aparatura të reja siç është ajo e Gjinekologjisë, Klinika e Kirurgjisë Torakale, Kirurgjia Vaskulare si dhe është bërë edhe

përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe rritje e disiplinës brenda stafit shëndetësor", është thënë në njoftimin e AVONET. Për performancë të mirë të punës është vlerësuar edhe Ministria e Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK). Sipas AVONET, MFSK-ja është në procesin e transformimit të saj, ku është e përkushtuar

për ngritjen e kapaciteteve dhe arritjen e përbushjeve të kriterëve për transformimin e FSK-së. "Kjo ministri ka arritur t'i përbushë kriteret dhe të zhvillojë politika të favorshme, po ashtu si një prej institucioneve më të besuara nga qytetarët", është theksuar në njoftimin e AVONET.

Sfidë e Kosovës, ikja e të rinjve në Perëndim



Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka bërë me dije se vetëm në tre vjetët e fundit rreth 10 mijë qytetarë të Kosovës kanë marrë viza të punës në shtetet perëndimore për një jetë më të mirë. Këto komente Lluka i bëri gjatë vizitës në Qendrën e Trajnimeve në Korporatën Energjetike të Kosovës. Ai ka theksuar se është sfiduese ikja e kuadrove, e cila po shkakton dëme të mëdha në vend

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka vizituar të mërkurën Qendrën e Trajnimeve në Korporatën Energjetike të Kosovës me ç'rast është prituri nga ushtruesi i detyrës së drejtorit menaxhues në KEK, Njazi Thaçi. Me këtë rast, Lluka ka thënë se vetëm në tre vjetët e fundit rreth 10 mijë qyete-

tarë të Kosovës kanë marrë viza të punës në shtetet perëndimore për një jetë më të mirë. Ai vuri në pah se është sfiduese ikja e kuadrove e cila po shkakton dëme të mëdha në vend. Sipas tij, këto shkathtësi që po zhvillohen në Qendrën e Trajnimeve në KEK janë në të mirë të vendit, sepse Kosova ka mungesë jashtëzakonisht të madhe të kuadrove në nivel të vendit. "Po flasim për ikje të kuadrove nga vendi, gjithashtu

edhe për mungesë të certifikimeve të ndryshme ndërkombëtare. Nëse ne vetëm me ndërtimin e Termocentralit (Kosova e Re) do të punësojmë qindra saldues dhe teknikë të ndryshëm, ku do t'i marrim ata? Sfida është se ne në vitet e kaluara, për tre vjetët e fundit, diku rreth 10 mijë veta, persona të certifikuar, kanë marrë viza punë për në vendet e Perëndimit, siç është Gjermania. Kjo normalisht neve na shkakton një dëm afatshkurtër, sepse ato kapacitete nuk i kemi zëvendësuar. Andaj, kjo është ideja dhe qëllimi i vizitës të shikohen format se si mund të certifikohen më shumë persona me shumë shkathtësi dhe të arrihet të mos ketë një hapësirë ku duhet të importohet fuqi punëtore nga vendet e ndryshme të rajonit", ka thënë Lluka.

Ai është zotuar se do të angazho-

het që të sigurohen sa më shumë bursa për studentët për krijimin e këtyre shkathtësive për certifikim ndërkombëtar pasi, sipas tij, është i domosdoshëm për të gjitha kompanitë. Kurse ushtruesi i detyrës së drejtorit menaxhues në KEK, Njazi Thaçi, ka prezantuar kapacitetet që ka Qendra e Trajnimeve në KEK për aftësimin profesional të të rinjve dhe mundësitë që tani do të ofrojë kjo qendër për trajnime në disa teknologji. Ai ka thënë se në Qendrën e Trajnimeve janë trajnuar punëtorë të KEK-ut, të cilët kanë treguar rezultate të jashtëzakonshme dhe falë tyre KEK-u është një kompani me performancën më të mirë në Kosovë, me një fitim mbi 20 milionë euro. Ai ka shtuar se përpos trajnimeve për punëtorët e KEK-ut, kjo Qendër kryen trajnime edhe për të rinjtë që janë të interesuar jashtë KEK-ut me kërkesë të donatorëve, kompanive

të ndryshme si dhe për fakultete. "Tani ne kemi bërë një strategji që t'u ofrojmë të rinjve të Kosovës një mundësi trajnimi që të përgatiten për tregun e punës. Kemi trajnerë të përgatitur profesionalisht, të certifikuar ndërkombëtarisht, kryesisht në vendet e Bashkimit Evropian. Trajnimet që kjo qendër kryen janë kryesisht teknike, si: teknologji elektrike, teknologji makinerie si dhe teknologji e saldimit. Përpos këtyre trajnimeve, kjo qendër kryen edhe trajnime të tjera siç janë: trajnimet e IT-së të menaxhimit të sigurisë industriale si dhe trajnime kundër zjarrit", ka deklaruar Thaçi.

Fillimi i punës së Qendrës së Trajnimit ka nisur në maj të vitit 2005, ku ndërtimi i Qendrës dhe pajisja e zyrave, laboratorëve dhe punëtorëve është financuar nga burimet e KEK-ut dhe nga Agjencia Evropiane për Rindërtim.

Hotelet e Kosovës u vizituan nga 68 mijë vizitorë

PRISHTINË, 5 SHTATOR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Statistikat e Hotelerisë në Kosovë" për tremujorin e dytë (TM2) 2018. Në tremujorin e dytë të vitit 2018 (TM2 2018) pjesë e anketës kanë qenë 187 hotele që ushtrojnë veprimtari hoteliere në territorin e Kosovës. Pjesa më e madhe e tyre gjenden në rajonin e Prishtinës, pastaj të Pejës, Prizrenit etj. Sipas anketës,

kapaciteti i shfrytëzuar në nivel vendi është 11.25 për qind. Në TM2 2018 numri i vizitorëve ishte 68 609, prej tyre 36.45 për qind ishin vendorë dhe 63.55 për qind ishin të huaj. Ndërsa numri i netëqëndrimeve (bujtjeve) në TM2 2018 ishte 109 631, prej tyre 35.16 për qind nga vendorët dhe 64.84 për qind nga të huajt. Numrin më të madh të vizitorëve dhe netëqëndrimeve të tyre e ka rajoni i Prishtinës me 25 422 vizitorë dhe 38 679

netëqëndrime.

Numri më i madh i vizitorëve të huaj përqendrohet në Prishtinë, Prizren e kështu me radhë. Sa i përket vizitorëve të huaj, numri më i madh ishte nga Shqipëria, Gjermania, ShBA etj. Këtij publikimi i është bashkangjitur edhe një shtojcë e veçantë, që përmban të dhënat nga Policia e Kosovës lidhur me numrin e vizitorëve të huaj sipas pikëkalimeve kufitare gjatë vitit 2017.



Shpërndahen 60 motokultivatorë për fermerët prizrenas

Prizren, 5 shtator (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka bërë me dije se kanë bërë shpërndarjen e 60 motokultivatorëve për fermerët përfitues të kësaj komune. "Me anë të subvencioneve të shumta bujqësore po përpiqemi që vazhdimisht t'i rrisim kapacitetet prodhuese të bujqve të komunës sonë. Kështu, sot, bashkë me drej-

torin e Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, kemi bërë shpërndarjen e 60 motokultivatorëve për fermerët përfitues. Për këta fermerë nuk është e mjaftueshme vetëm shtimi i prodhimit, por edhe krijimi i lehtësirave që këto prodhime të arrijnë deri te konsumatori vendor apo ndërkombëtar. Toka duhet të punohet sa më shumë", ka deklaruar Haskuka.



Kryetari i Skenderajt kërkon ndihmën e investitorëve gjermanë

Skenderaj, 5 shtator (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritur në takim të mërkurën Labinot Gucatin, sekretar i parë, i njohur nga autoritetet gjermane si konsull në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Mynih të Gjermanisë, me të cilin ka bise-

duar rreth mundësive të bashkëpunimit në mes të Konsullatës së Përgjithshme dhe Komunës së Skenderajt. Kryetari Jashari e ka njoftuar mysafirin për zhvillimet në Komunën e Skenderajt, për objektivat dhe për politikën që synojnë zhvillimin e vendit. Ndërsa sekretari i parë në

Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Mynih të Gjermanisë ka shprehur gatishmërinë për t'i ofruar mbështetje Komunës së Skenderajt sa i përket krijimit të urave të bashkëpunimit në mes të autoriteteve lokale të Skenderajt dhe investitorëve gjermanë.



Nis ndërtimi i shtëpisë për një familje skamnore në Budakovë

Therandë, 5 shtator (ER) - Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, dhe drejtuesi i Shoqatës "Jetimat e Ballkanit", kanë nisur ndërtimin e një shtëpie për një familje skamnore në

fshatin Budakovë të kësaj komune. Me këtë rast, Muharremaj ka falënderuar Kastratin për ndihmën e dhënë për familjet në nevojë. "Falënderimi i takon Halil Kastratit dhe Shoqatës

Bamirëse 'Jetimat e Ballkanit' e cila, në bashkëpunim me ne, po realizon ndërtimin e një shtëpie tjetër në Budakovë. Vullneti për të ndihmuar na udhëheq që të bashkëpunojmë për ata që kanë nevojë", ka thënë Muharremaj.

Ndriçohen parkingjet në 'Bregun e Diellit'

PRISHTINË, 5 SHTATOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se në kuadër të projekteve infrastrukturore ka rregulluar ndriçimin në parkingjet e lagjes "Bregu i Diellit" në kryeqytet. Kjo

komunë ka theksuar se është duke punuar për krijimin e një mjedisi sa më të sigurt për qytetarët e Prishtinës. "U ndriçuan parkingjet në 'Bregun e Diellit' si dhe pjesa

rreth qendrës tregtare. Po punojmë për të krijuar mjedis sa më të sigurt për në çdo pjesë të qytetit", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



Gashi e Lekaj flasin për projektet infrastrukturore në Kastriot

KASTRIOT, 5 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Kastriotit, Xhafer Gashi, është takuar me ministrin e Infrastrukturës, Pal Lekaj, me të cilin ka biseduar për projektet infrastrukturore që pritet të realizohen në këtë komunë në vitin e ardhshëm. "Kryetari takoi ministrin në Ministrinë e Infrastrukturës, Pal Lekaj, për të diskutuar për projektet infra-

strukturore që janë në zhvillim dhe për planifikimet e projekteve infrastrukturore për vitin 2019", ka njoftuar Komuna e Kastriotit.



Çerçilli, Gërvalla dhe... Lala



Nga Bedri ISLAMI

Asnjë lidhje nuk ka mes këtyre të treve; as nuk janë njohur dhe dy të parët as që kanë dëgjuar për të tretën. I ka bashkuar një gjë: profesioni i gazetarit dhe fakti që, përmes këtij profesioni apo pasioni, ata janë bërë të njohur, megjithëse në shkallë të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme.

Çerçilli, në rininë e tij ishte ushtarak, oficer kalorësie, shkalla më e ulët e linjës së trupës ushtarake angleze. Pavarësisht se në shkollë kishte qenë gjithnjë i fundit, aq sa babai i tij, herë pas here e qortonte ashpër, ai kishte pasionin e gazetarit brenda vetes; jo si ecuri në botën e letrave, por si një shkallë drejt politikës. Ndoshta nga që gjyshi i tij nga nëna, një amerikan ambicioz, ishte manjati i disa mediave të fuqishme, mes tyre edhe i "New York Times"-it.

Kërkoj ai rrezikun në luftë që të bëhej i njohur dhe të futej në politikë. I kërkonte nënës së tij që të përdorte gjithë njohjet, që të ishte në zonat e rrezikshme të luftimeve në perandorinë angleze, që të kishte një të shkuar për politikanin e ardhshëm, por lufta nuk ia preu kurrë kostumin që donte.

Ia zgjodhi gazetaria. I dërguar si korrespondent lufte, kur anglezët në Afrikën e Jugut luftonin kundër boerëve holandezë, i zënë rob lufte, i arratisur, i ndjekur, i kërkuar përmes shpërblimeve të ndjeshme për kohën, i fshehur në një tren mes dengjeve të pambukut, befasisht merr vesh se aventura e tij në Afrikën e Jugut ishte shumë më tepër se çfarë kishte pritur vetë ai. Ishte rrezikuar në Indi, mes kufirit me Pakistanin e ardhshëm, ishte tunduar përmes gjakut në Afganistan, ishte përpjekur në Egjipt, gjithnjë majë një kali luftarak, por e kishte gjetur vetëm atëherë kur kishte qenë gazetar.

I kishte filluar reportazhet ende pa u bërë 22 vjeç; të forta, të sinqerta, të drejtpërdrejta, pa asnjë fshehje, asnjë mashtrim, dhe ishte bërë aq i vështirë, sa që asnjë gjeneral nuk e donte pranë vetes.

Gërvalla, Jusuf Gërvalla, një gazetar i shkëlqyer nuk u bë i njohur fillimisht si gazetar, por si martir dhe hero i popullit të tij dhe i vendit të tij: Kosovës. Fjala e tij e shkruar, si gazetar, nuk kishte qenë gjithaq e njohur, ndoshta nga që ishte i ri, por kishte qenë mjaftueshëm e rrezikshme sa që për t'u bërë sinjali i vrasjes së tij.

Shpesh herë kam menduar,

përse, aq mizorisht, shërbimet e fshehta serbe bënë vrasjen e 17 janarit 1982, kur tre vetë, mes tyre dy njerëz të letrave, Jusufi dhe Kadri Zeka, së bashku me Bardhosh Gërvallën, vëllanë e Jusufit, u vranë në pragun e shtëpisë së tyre, në një shtet të huaj, të quajtur tepër i sigurt, në Gjermani.

Jusufi do të ishte mentari i parë në perëndim i lëvizjes ilegale çlirimtare. Nacionalist i dorës së parë me një lëvizje të së majtës, ai po bëhej shumë shpejt njeriu rreth të cilit po mbledheshin njerëzit që kishin vendosur të protestonin dhe të kërkonin ndryshe lirinë e vendit të tyre. Në fakt ai ishte vazhdimi i pranverës studentore.

Viti 1981 sapo kishte ikur, përgjakshëm, rrëmujshëm, por shpresëplotë. Njerëz të guximshëm kishte plot, lider nuk kishte. Kishte ardhur koha e liderëve dhe atë e morën përsipër dy njerëz të letrave, Kadri Zeka dhe Jusuf Gërvalla.

Jusufi e kuptoi se fraza e lëmuar, poetike, e rrjedhshme, mes kujdesit dhe lëmimit, ndoshta nuk e kishte kohën e saj. Ishte koha e fjalës së drejtpërdrejtë, të lexueshme qartas, të kuptueshme lehtësisht dhe të ndjekur besnikërisht.

Kur ai e tha këtë fjalë, atë e vranë. Sepse fjala e ndershme ka gjithherë pagesën e saj.

Më janë kujtuar të gjitha këto nga një ngjarje e ditëve të fundit dhe që ka lidhje të drejtpërdrejtë me gazetaren Klodiana Lala.

Shtëpia e prindërve dhe e vëllait të saj u qëllua në një thyerje mesnate. Ora tre e natës. Tmerr të të përplasen plumbat në murin e shtëpisë apo në xhamat e portës

kryesore.

Tmerr për cilindo, aq më shumë për një familje që ka në rrethin e saj një gazetare, aq më tepër të kronikës, investigative, herëherë e guximshme. Edhe më e rëndë bëhet e gjithë kjo kur mendon se në atë shtëpi, rastësisht, ndodheshin edhe dy fëmijët e zonjës Lala, e cila, si mësuam, banon diku tjetër. Të nisësh jetën përmes plumbave është një fillim i pazakontë, i cili kërkon një gjë të shpejtë dhe të sigurt, zbardhjen e ngjarjes.

Ka ndodhur me synim Lalën apo njerëzit e saj, kjo nuk është e rëndësishme. Ka pasur edhe raste më mizore mbi gazetarët në kohën berishiane, edhe kjo nuk është e rëndësishme. Secilës ditë i del mjaft pikëllimi i saj - thuhet në librin e shenjtë kristian.

Edhe kësaj dite i del pikëllimi dhe trazimi i saj.

Zonjën Lala nuk e njoh. Nuk e kam takuar asnjëherë dhe as nuk besoj se mund të takohemi. Moshë të ndryshme, tema të tjera, miq të tjetërsoj. Jeta ka të papriturat e saj dhe gjithçka mund të ndodhë. Uroj që kjo të mos përsëritet - që jeta e saj të rrjedhë e qetë, e pa shprishur. Normalitet i zakonshëm.

Por e kam ndjekur disa herë në mjediset televizive, pikërisht në temat investigative. Nuk e kam krahasuar me të tjerë, dhe as që kam ndër mend ta bëj këtë. Zakonisht rri në kahun e opozitës, megjithëse një gazetar investigativ duhet të jetë gjithnjë si i të vërtetës, më shumë si i pjesëve partiake. Zakonisht kështu duhet të jenë të gjithë gazetarët, por veçmas ata investigativë. Ata ngjallin edhe më

shumë solidaritet. E bënë të gjithë këtë, deri edhe Gjykata e Lartë e Prokuroria e Përgjithshme, ku nesër mund të gjykohej tentuesit dhe që mund t'i nxjerrin të pafajshëm ose përmes një dënimi minimal, si ka ndodhur shpesh herë.

Lala nuk ka nevojë për këtë, ajo kërkon të vërtetën, ashtu si e kërkojnë gjithë të tjerët. Ka shumë vrasje të mbetura në errësirë në këtë vend. Njëra prej tyre, ajo e Azem Hajdarit, pritet të rigjykohej, megjithëse duhej gjykuar saktë që asaj kohe. Edhe ai që nuk shkon për të dëshmuar bën një krim të vetin; edhe ai që fsheh se çfarë ka thënë një dëshmitar i incizuar bën një krim tjetër.

Zonja Lala është një zë në botën e gazetarisë investigative, zë i drejtpërdrejtë, por jo gjithnjë i saktë.

Fjala nuk bën mort, thonë të vjetrit, por gjuha kocka nuk ka, e kocka thyen.

Jo rrallë herë, në diskutimet e saj të shumta, në të drejtën e saj, kam dëgjuar të thotë, edhe kur gjërat janë krejt ndryshe, "nga burimet e mia informative", edhe pse këto burime mund të mos kenë qenë askund apo të kenë dhënë informacion të rrejshëm.

Të bësh kujdes me fjalën, edhe pse mund të ndodhesh i rrezikuar, si në rastet e sipërm, njëri, Çerçilli, nga gjeneralët e tij që i kishin në duar karrierën; tjetri, Gërvalla, nga shërbimet e vendit pushtues që i kërcënonin jetën, është më e vështira e, shpesh herë më e pamundura në jetën e një njeriu të fjalës së shkruar.

E di se si mund të jenë ndjerë prindërit e zonjës Lala asaj nate e

si ndihen edhe tani. Më kujtojnë nënën time një natë tetori 1992, kur dy njerëz me armë, pas mesnatës, shpërthyen portën e hyrjes në shtëpinë time dhe kërcënuan. Ishte rasti i vetëm i ndodhur në qytetin tim, megjithëse isha gazetar i vetëm opozitar i atyre viteve të para. Pastaj mora vesh se kishin ardhur nga një qytet tjetër, më verior, se kishin pyetur dy herë se ku ishte shtëpia ime dhe, pasi kishin thyer derën, asaj kohe ajo ishte me dritare të xhamta se ende nuk ishim mësuar me erën e krimit, kishte ngjarë ajo që pasoi.

E kuptoi se si ndjehen edhe prindërit e atyre që në emisione të ndryshme investigative, jo vetëm Lala, por edhe të tjerë, shpejtojnë t'i quajnë kriminelë, hajdutë, vrasës, e një mijë të tjera, të cilat më pas, jo shumë larg, saktësohen si krijesa të çastit ose të llogaritura qetësisht për një zhurmë të çastit.

Fjala, ndryshe nga sa mendojmë, të vret.


Që mos të vrasë, duhet të jetë e qetë, e guximshme, e matur, edhe kur ajo mund të bjerë si rrebesh mbi fatin e mbi jetën tonë.

Disa herë zonja Lala ka bërë këtë gjë të saktë dhe të vyer, por jo gjithnjë.

Por askush nuk ka të drejtë të ligjërojë krimin. Të bëhet pjesë e krimit.

Mos i ndodhtë askujt çfarë ndodhi në shtëpinë e prindërve të saj. Një gazetarë trime nuk ndalet nga krimi. E unë besoj se edhe ajo nuk do të ndalet.

Por shembujt që solla në fillimin e këtij shënimi ndoshta mund të na shërbejnë për rëndësinë e fjalës së ndershme.



Sekretari Pompeo në Pakistan

Islamabad, 5 shtator - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, mbërriti të mërkurën në Pakistan për takime të nivelit të lartë me udhëheqësit e qeverisë së sapozgjedhur në Islamabad, me qëllim për t'i mbështetur marrëdhëniet dypalëshe të cilat ndodhen në pikën më të

ulët prej vitit të kaluar. Duke folur për gazetarët derisa udhëtonte drejt Pakistanit, Pompeo tha se misioni i tij është që të dy vendet të bëjnë përpara së bashku dhe ta tejkalojnë ngërçin e krijuar në marrëdhënien e komplikuar të Islamabadit me Uashingtonin. Në këtë vizitë Pompeo

shoqërohet nga shefi i Shtatmadhorisë Joseph Dunford, gjë që vë theksin te përpjekjet amerikane kundër terrorizmit.

Delegacioni amerikan do të zhvillojë bisedime zyrtare me ministrin e Jashtëm Shah Mehmood Qureshi dhe stafin e tij.



Britania dhe pasojat e daljes nga Bashkimi Evropian

Nëse Britania del nga Bashkimi Evropian marsin e ardhshëm pa një marrëveshje, rrezikon çrregullime të mëdha në ekonominë dhe shoqërinë e vet, duke përfshirë tregtinë, transportin, kujdesin shëndetësor dhe të drejtat e shtetasve të vet

LONDËR, 5 SHTATOR - Britania rrezikon çrregullime të mëdha në ekonominë dhe shoqërinë e saj, duke përfshirë tregtinë, transportin, kujdesin shëndetësor dhe të drejtat e shtetasve të vet, nëse del nga Bashkimi Evropian marsin e ardhshëm pa një marrëveshje. Ky është përfundimi i një raportu të ri mbi rreziqet afatshkurtra të një "Brexit-i pa marrëveshje". Publikimi i raportit përkon me kthimin e ligjvënësve në Londër pas një pushimi veror gjashtë javësh, për t'u ballafaquar me pasigurinë në rritje rreth marrëdhënieve të ardhshme të Britanisë me Bashkimin Evropian. Britania ka përjetuar verën më të nxehtë në historinë e saj, por një stuhi e madhe politike është duke u formuar ndërsa ligjvënësit britanikë kthehen në Londër.

Marrëveshja për dalje ende nuk është nënshkruar me Brukselin, duke rritur mundësinë e një Brexiti kaotik më 29 mars të vitit të ardhshëm, thonë autorët e raportit "Britania e Madhe në një Evropë në ndryshim". "Askush nuk dëshiron të mos ketë marrëveshje, por ka pengesa të mëdha. E para është ajo e kufirit irlandez, ku për momentin qëndrimi i Bashkimit Evropian është se duhet të ketë një trajtim të veçantë për Irlandën e Veriut, të shkruar ligjërisht në marrëveshje, e cila siguron se nuk do të ketë barriera kufitare dhe që ajo të mbetet deri-diku e lidhur ngushtë me BE-në", thotë Jonathan Portes, profesor në Kings College. Por kjo është e papranueshme për shumë ligjvënës britanikë të cilët kanë frikë se kjo përfundimisht mund ta shkëpusë Irlandën e



Veriut nga Britania e Madhe. Shumë ligjvënës nuk duan t'ia paguajnë faturën e divorcit prej 50 miliardë dollarësh Evropës, fonde nga detyrimet ekzistuese, pa një garanci për një marrëveshje të ardhshme tregtare. Evropa refuzon t'i japë Britanisë një premtim të tillë.

Pra, nuk ka të bëjë vetëm me tregtinë. Gjëra të tjera të llojeve të ndryshme do të ndikoheshin negativisht më 30 mars nëse ne nuk arrijmë një marrëveshje. Raporti paralajmëron se tregtia

me Bashkimin Evropian do të ndeshet me çrregullime të menjëshme, me mungesa të mundshme në ushqime dhe ilaçe. Certifikatat e sigurisë për aeroplanët britanikë do të bëheshin të pavlefshme, ndoshta disa fluturime do të anuloheshin. Do të ketë pikëpyetje në lidhje me të drejtat e qytetarëve britanikë që jetojnë në Bashkimin Evropian. Por, qeveria këmbëngul se nuk ka të ngjarë të ketë Brexit pa një marrëveshje. "Ne po ndërmarrim veprime për të shmangur, për t'i

minimizuar dhe për të zbutur këto rreziqe potenciale që të jemi të përgatitur për të menaxhuar çdo çrregullim afatshkurtra", thotë Raomin Dominik, sekretar i Shtetit për dalje nga BE-ja.

Por disa qeveri evropiane po u rezistojnë kërkesave për t'i bërë lëshime Britanisë. "Ekziston një pikëpamje në Evropë, sigurisht në Francë, Gjermani dhe në Komisionin e BE-së, se çdo lloj marrëveshjeje që do t'i lejonte Britanisë të përfitonte nga lëshimet do t'i inkurajonte ata që duan shpërbërjen dhe forcat populiste diku tjetër në Evropë", tha ai.

Betejat politike u pasqyruan në det të hapur kohët e fundit, pasi peshkatarët britanikë dhe ata francezë u përleshën në La Mansh. Franca ka paralajmëruar se mund ta dërgojë marinën e saj për t'i monitoruar mosmarrëveshjet. Të drejtat e peshkimit janë një problem tjetër që ende nuk është zgjidhur.

Dalja e Britanisë do të diskutohet në një takim të udhëheqësve të Bashkimit Evropian që do të mbahet më vonë këtë muaj në Austri.

Trumpi do ta kryesojë takimin e liderëve botërorë në KS të OKB-së



Nju Jork, 5 shtator - Presidenti amerikan Donald Trump do ta kryesojë takimin e këtij muaji të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në kuadër të mbledhjes vjetore të liderëve botërorë në Nju Jork, për t'i theksuar pakënaqësitë e tij kundër Teheranit.

Ambasadorja amerikane në këtë Organizatë, Nikki Haley, ka njoftuar se Trumpi do ta udhëheqë mbledhjen teksa ShBA-ja nis këtë vit udhëheqjen në Këshill të Sigurimit, pavarësisht se vitin e kaluar ka bërë thirrje të pasuk-

sesshme për masa ndëshkuese kundër Iranit.

Haley dhe Trumpi kanë sulmuar vazhdimisht Iranin, duke e akuzuar për ndërhyrje në luftën në Siri dhe atë në Jemen, si dhe për, siç është shprehur presidenti amerikan, shkelje të shpirtit të marrëveshjes bërthamore të vitit 2015. Haley u ka thënë gazetarëve në OKB, se Trumpi ka vendosur të marrë pjesë në mbledhjen e 26 shtatorit ashtu që "t'i adresojë shkeljet e ligjit ndërkombëtar nga Irani dhe për jostabilitetin që krijon

ky vend në gjithë rajonin e Lindjes së Mesme". "Presidenti Trump është shumë i vendosur që ne duhet të sigurohemi se Irani është në linjë me rregullin ndërkombëtar", ka thënë Haley, e cila ka akuzuar Iranin për "mbështetje të terrorizmit" në gjithë botën. "Nëse vazhdoni të shikoni në testimet e raketave balistike që janë duke bërë, nëse shikoni shitjen e armëve për rebelët huthi në Jemen, të gjitha këto përbëjnë shkelje të rezolutave të Këshillit të Sigurimit", është shprehur ajo.

Erdogani paralajmëron 'masakër' në Idlib të Sirisë

ANKARA, 5 SHTATOR - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, paralajmëroi se sulmi në provincën Idlib të Sirisë mund të shkaktojë "masakër". Komentet vijnë derisa forcat qeveritare siriane po përgatiten për një ofensivë të madhe në rajonin e fundit të kontrolluar nga rebelët. "Një masakër serioze mund të ndodhë nëse atje

hidhen raketa", tha Erdogan. Ai, po ashtu, paralajmëroi për rrezikun që luftimet e rënda të shkaktojnë fluks të madh refugjatësh në Turqi. Idlibi kufizohet me Turqinë dhe është enklava e fundit e madhe e mbajtur nga kryengritësit që luftojnë presidentin sirian Bashar al-Asad dhe forcat ruse dhe iraniane.

Këto të fundit kanë luajtur rol të madh në mbështetjen e Assadit gjatë luftës në Siri. Mijëra trupa qeveritare dhe luftëtarë aleatë janë vendosur tashmë në zonat që rrethojnë Idlibin. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, po ashtu ka paralajmëruar Assadin dhe aleatët e tij kundër "sulmeve të pamatura" në Idlib.



Vështrim kritik

Luginasit brenda një libri monografik

Bilall MALIQI

Sikurse në shumë shtete të botës që ka shqiptarë, nga të gjitha trojet e ndara, edhe në Kanadanë e largët gjenden shqiptarë të migruar, ndër ta edhe nga Lugina e Preshevës, të cilët jetojnë dhe veprojnë në këtë shtet dhe mundohen në mënyra të ndryshme të punojnë dhe të mbijetojnë me punën e tyre.

Njëri nga këta është edhe Mustafë Ismaili, shkrimtar, i cili është nga Lugina e Preshevës, përkatësisht nga fshati Samolicë, komuna e Bujanocit, që jeton dhe vepron në Kanada, ku në shkrimet e tij si në poezi, ashtu edhe në prozë, shpërfaqë ndjenjat e tij prej krijuesi, të cilat i manifeston nëpër vargje poetike, por edhe në prozë, me të cilën identifikohet me mirë dhe më lirshëm.

Tematikat që Mustafa i përzgjedh në shkrimet e tij së pari në poezi, pastaj edhe në prozë, kanë atë lidhshmërinë shpirtërore me atdheun, sepse është i lidhur ngushtë me vendlindjen e tij, por jo vetëm kaq, Mustafa i shkruan edhe motivit patriotik në vargjet e tij poetike, të cilat janë të drejtpërdrejta, pa ndonjë hermetizim, porse lexohen dhe kupohen nga secila shtresë e lexuesve, por që kanë mesazh të qartë dhe me këto poezi identifikohet ky krijues i zellshëm dhe i palodhshëm, i cili krijon si mërgimtar në këtë shtet të largët.

U mor vesh se fahu i Mustafës është proza, të cilën e shkruan me shumë ndjesi dhe seriozitet, kjo shihet që nga romani "Rruga pa adresë" me të cilën libër sheshon ngjarje të vërteta, të ndodhura në një kohë jo edhe aq të largët e që ka lënë gjurmë të pashlyeshme në mbamendjet tona, por edhe të autorit, sepse në atë kohë të pa kohë, në kohën e luftës dhe të spastrimit etnik që iu bë shqiptarëve të pafajshëm, pjesë e këtij eksodi ka qenë edhe vetë Mustafa, e që i ka lindur edhe ky insiprim ndoshta i "imponuar" për ta filluar një roman me ngjarje dhimbse dhe rrëqethëse, me një titull prekës dhe korrekt "Rruga pa adresë", meqenëse të gjithë këta të dëbuar nuk kanë pasur adresë të saktë se ku do të ndalen, siç nuk ka pasur as Mustafa. Pra është një kohë që pasqyron një tablo shumë reale të asaj kohe

të pakohë.

Edhe në romanin tjetër me titull "Shtigjeve të natës", para lexuesve paraqitet një pasqyrë shumë e qartë e rregullimit të skeletit të romanit, e që brendia e tij shoqërohet me një pasqyrim korrekt të autorit karshi motivit të zgjedhur për ta trajtuar brenda këtij romani. Në këtë roman e gjen veten çdo i ri dhe si kryepersonazh është një i ri, i cili rrugëton në ngjarjen e romanit nga prologu deri te epilogu i tij. Dhe nuk themi kot se Mustafa identifikohet më tepër si prozator, edhe pse shkruan edhe poezinë, por lexuesi aty e gjen veten më mirë dhe në mënyrë më komode.

Tek monografia "Me Luginasit e mi në Kanadanë e largët", para nesh na del një përpjekje serioze e autorit që të mbledhë të dhëna autobiografike të protagonistëve që jetojnë së bashku brenda kopertinave të këtij libri voluminoz dhe tërheqës për lexim dhe për shtjellim. Mustafa në këtë libër ka gjurmuar anekënd Kanadasë luginasit e tij të shpërndarë gjithandej këtij shteti e që nuk ka qenë aq punë e lehtë për autorin, sepse ai ka gjurmuar shumë kohë deri në gjetjen, sistematizimin dhe përpilimin e lëndës së punës për të ecur mandej edhe në etapa të caktuara kohore, të cilat i ka paraqitur edhe në libër deri në finalizimin e këtij libri, e që është një punë e lodhshme, por shumë lavdëruese për autorin dhe një e mirë edhe për lexuesit, dhe të interesuarit tjerë se tani i kanë të prezantuar brenda këtij libri simpatik.

Përveç parathënies së redaktorit të librit, Namik Selmani dhe të fjalës hyrëse të autorit, libri shoqërohet me këta kapituj apo cikle: /Dëbimi i shqiptarëve në trojet e veta/, ku autori kthehet prapa në histori që nga Perandoria Osmane, me dëbimet e shqiptarëve nëpër kohë dhe situata të ndryshme e që kanë reflektuar negativisht për ardhmërinë e tyre, të cilat janë shoqëruar me hidhërime, pezmë dhe vajtime për largimin e tyre me dhunë nga trojet e tyre stërgjyshore e që më nuk kanë mundur dhe nuk iu është lejuar kthimi në vendet e tyre, si bie fjala dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku, Toplica, Nishi etj., dhe nga vendet ku kanë jetuar shqiptarët me shekuj të tërë. Pra është ky një kapitull i gjerë për të cilën kanë shkruar shumë

historianë, e që autori përmend disa etapa me rëndësi historike sa i përket dëbimit të shqiptarëve.

Në kapitullin /Lugina e Preshevës/, Mustafa jep sqarime të thukëta për këtë krahinë të populluar me shumicë shqiptare. Jep një kronologji historike për këtë krahinë që nga shekulli i VI dhe VII, duke rrugëtuar kështu nëpër etapa kohore deri te ngjarjet e fundit të luftës së lavdishme të UÇPMB-së, të cilët e ndërruan për 90 shkallë historinë e popullit shqiptar të këtyre komunave dhe të shqiptarëve në përgjithësi. Mustafa në vazhdim na paraqet relievin, klimën, ekonominë dhe demografinë e Luginës së Preshevës, pa të cilat ky libër monografik do të ishte i mangët, për të kaluar në reportazhet e prezantuar për tri komunat tona veç e veç, duke filluar me historikun e shkurtër të komunave, shtrirjen gjeografike, numrin e popullatës, përqindjet e tyre nacionale, kulturën, politikën, informimin etj., gjë që e bënë librin tërheqës për lexim.

Pjesë e librit janë edhe kapitujt tjerë me rëndësi/ Historia e shoqatës shqiptaro kanadeze/, në të cilën jepet një kronologji e kësaj shoqate që mbledh shqiptarët që jetojnë dhe veprojnë në këtë shtet, historiku dhe themeluesit si dhe anëtarët që japin kontributin e tyre, duke u organizuar dhe duke organizuar aktivitete të

ndryshme në të mirë të komunitetit shqiptar.

Duke e shfletuar librin, para nesh na dalin personazhet të cilët autori i ka mbledhur sikur lulet në kopsht dhe ua ka servuar lexuesve që ata të njihen me biografite e tyre dhe me aktivitetet që i kryejnë ata në këtë shtet të largët. Shumica dërmuese janë nga Lugina e Preshevës, por kemi edhe mysafirë, miqtë të shqiptarëve të Luginës, të cilët e nderojnë librin, por që edhe autori i ka nderuar dhe i ka futur në mesin e luginasve tanë që jetojnë dhe veprojnë në Kanada. Veçantia është se po këta personazhe janë me fotografite e tyre kolor dhe me të dhënat e tyre të shkurtër, aq sa iu kanë nevojitur autorit për një prezantim dinjitoz të tyre në libër.


Ky libër e ka vlerën e vet, sepse të punosh, të gjurmosh, të rrugëtosh nëpër këtë shtet të madh dhe të mbledhësh të dhëna, nuk është edhe e lehtë, tevona edhe mbarështimi i brumit të shënimeve të mbledhura, sistemimi i tyre dhe rregullimi i kësaj monografie, konform rregullit që e kërkon një monografi me vlerë.

Mustafa Ismaili është mjaft punëtor, gjurmues i motiveve, gjetës i mirë i ideve, të cilat i konkretizon në zhanret përkatëse, por më së miri në prozë, sepse dihet mirëfilli se shkrimi i poezisë kërkon më shumë art, vlerë, siç thotë i madhi Azem Shkreli, "Mos u

bëj poet nëse s'mund të vdesësh për secilin varg, të vdesësh për secilën fjalë".

Vlen të theksohet se ky libër kohë më parë u përrua në komunën e Bujanocit, në të cilën kanë marrë pjesë një numër i madh i artdashësve nga Lugina e Preshevës dhe nga Kosova, ku referuesit kanë dhënë kritikë shumë pozitive për këtë monografi. Po ashtu Mustafa çdo herë që vjen në vendlindje përrua vepra të reja, edhe në Preshevë dhe në vende të tjera, të cilat i boton brenda një viti kalendarik, e që i prezanton para lexuesve të tij. Përveç këtyre librave në poezi dhe në prozë, Mustafa ka përkthyer dhe ka botuar libra edhe në gjuhën angleze si: "A journey Without Destination" (Rruga pa adresë), romanin "The night trails" (Shtigjet e natës) dhe romanin "Deportation with violence" (Dëbimi me dhunë).

Marrë në përgjithësi ky libër i karakterit monografik i shkrimtarit Mustafë Ismaili, libër kapital me format B/5, me brendinë e punuar kolor, shoqërohet me vlerë të begatshme artistike, gjithnjë duke pasur parasysh brendinë e librit dhe punën e palodhshme që e ka bërë, e që nuk është edhe aq e lehtë, se në shumicën e rasteve monografite bëhen në mënyrë ekipore, e këtë libër autori e ka bërë vetë, e për atë vlen të përshëndetet puna, aktiviteti dhe vullneti i tij, për t'ia arritur këtij qëllimi...



E rrallë

Gjellë e shërbyer në krikëll birre

Një restorant kanadez ka intriguar internetin me një kthesë të re të ushqimit që e quan 'Ramen birrë'. 'Yuu Japanese Tapas' në Richmond, British Columbia shet gjellë, e

cila duket si krikëll birre e mrekullueshme me shkumë, teksa brenda saj ka edhe peta lundruese. Në fakt, nuk është birra fare, por është ngjashmëri me atë që ka lënë një



shije të çuditshme në gojën e disa njerëzve. 'Ramen birrë' shërbehet e ftohtë.

BARSOLETA E DITËS



- Kamerier, më sill një take-tuke, të lutem!
- Më fal zotëri, por në lokalin tonë nuk lejohet pirja e duhanit.
- S'do të pi duhan, por do të ha fara.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

"INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



FOTO E DITES



Foto e ditës: 13 qershor 1986, presidenti Ronald Regan qesh së bashku me Nënë Terezën dhe Motrën Frederik. /U.S. Embassy-Tirana/

Në ora 18:20

"FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

"ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

"LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 min

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

E jashtëzakonshme


Shkon ta vizitojë burgun, djali gjen të atin

Udhëtimi i një grupi nxënësish nga një shkollë në një burg Thai në Tajlandë u shndërrua në një takim të përzemërt midis një djali adoleshent, i cili njohu menjëherë një të burgosur që ishte babai i tij. Momenti emocional u zbulua në një postim prekës në rrjetin social "Facebook" të martën, i cili tha se palët 'u përplasën me njëri-tjetrin' në burgun e paidentifikuar në provincën Rayong.



 <p>DASHI Jeni pak të ndjeshëm dhe ndiheni keq kur dikush ju kap të papërgatitur. Me njerëz të rinj nuk ndiheni dhe aq shumë në humor.</p>	 <p>DEMI Edhe pse mendoni se jeni më të mirët, bëni mirë të riktheheni me këmbë në tokë, përpara se një eprori juaj ta bëjë këtë gjë.</p>	 <p>BINJAKËT Edhe pse sot do t'ju ofrohen disa alternativa, mos i merrni të gjitha të mirëqena. Është mirë t'i vlerësoni në detaje ato që vendosni.</p>	 <p>GAFORRJA Sot do t'ju ofrohen mundësi që nuk duhet t'i nënvlerësoni aspak, sidomos sa i përket aspektit të karrierës.</p>	 <p>LUANI Nëse dëshironi që personat që keni pranë të bëjnë diçka që ju përfshin dhe ju, bëni mirë të bashkëpunoni me ta duke lënë mënjanë paragjykimet.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Ndryshimet tuaja të humorit mund të bien në sy sot përgjatë ditës. Dikush do t'ju kërkojë të jeni më racional.</p>
 <p>PESHORJA Sot mund të mos merreni shumë me detajet që ju zënë zakonisht gjysmën e ditës. Ndonjëherë gjërat janë shumë më të thjeshta nga sa mendoni.</p>	 <p>AKREPI Nëse sot doni të merreni me diçka, nuk ka gjë më të mirë se aktivitetet kreative. Do të qetësoheni menjëherë.</p>	 <p>SHIGJETARI Sot lërimi mënjane ëndrrat dhe mundohuni t'i përshtateni sa më shumë realitetit. Për t'i zgjidhur dilemat tuaja, pyesni një mik.</p>	 <p>BRICJAPI Nëse dikush do t'ju bëjë pyetje sot, është mirë t'i përgjigjeni. Singjeriteti mund ta ndihmojë shumë marrëdhënien tuaj.</p>	 <p>UJORI Sot do t'i zgjidhni vetëm ato gjëra që ju pëlqen të bëni. Për të tjerat nuk doni të interesoheni fare.</p>	 <p>PESHQIT Planet tuaja për sot mund të shkojnë përtej asaj që keni menduar. Qëndroni të gatshëm për gjithçka që ju rezervon dita.</p>

Kourtney rikthehet me ish të dashurin?



Thuhet se Kourtney Kardashian është rikthyer me ish të dashurin Younes Bendjima. Spekulumet filluan gjatë fundjavës së kaluar. Megjithatë, burimet pranë Kourtney kanë thënë se ajo dhe

modeluesi 25-vjeçar nuk janë bashkë. Kourtney është 'mirë e vetme dhe nuk është bashkuar' me Younes, ka raportuar "TMZ". Lajmet për ndarjen e tyre nisën në fillim të gushtit.

Harry dhe Meghan mbështesin fëmijët e sëmurë



Harry dhe Meghan u janë bashkuar fëmijëve, prindërve dhe kujdestarëve për fëmijët e sëmurë në Londër. Princi Harry dhe gruaja e tij mbërritën të mërkurën për të marrë pjesë në një nga ngjarjet më frymëzuese të vitit të tyre të punës. Çifti po ndjek çmimet vjetore

WellChild për ta nxjerrë në pah guximin e fëmijëve të sëmurë rëndë dhe familjeve të tyre, duke i falënderuar ata që kujdesen dhe i mbështesin. Një nga fituesit këtë vit, Matilda Booth, pati rastin të fliste me Meghanin, me ç'rast asaj i dha një buqetë trëndafilash të bardhë.




Çfarë i ka ndodhur Cristiano Ronaldos që ka syrin e nxirë?

Ai është transferuar nga Real Madrid te Juventus për një shumë të majme, por ende nuk ka arritur ta justifikojë vlerën e madhe. Në tri ndeshjet e luajtura Ronaldo nuk ka arritur të shënojë. Mirëpo, pavarësisht se nuk shënoi

ndaj Parmës, ai tregoi se ka "luajtur fort". Ronaldo është fotografuar me syrin e nxirë, të cilin e dëmtoi gjatë ndeshjes me Parmën. 33-vjeçari po shijon pushimet me të dashurën 24-vjeçare Georgina Rodriguez.

Brown nuk dëshiron t'i japë më shumë para ish së dashurës për rritjen e vajzës së tyre

Chris Brown mendon se duke i dhënë më shumë mbështetje financiare ish së dashurës do të ndikojë në rritjen e fëmijës së tyre katërvjeçare, Royalty. Nia Guzman, e cila kohët e fundit ka punësuar një avokat të ri për betejën ligjore kundër Brownit, po kërkon 21 mijë dollarë



në muaj dhe 250 mijë sosh në mënyrë retroaktiv në mbështetje të fëmijës së tyre, shkruan "The Blast".

Recension i librit më titull: 'Çeshtja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe (1856-2018)'



Prof. dr. Haxhi FERATI

Mjeti diplomatik i vendit është ngritur dhe ndërtuar si mjet për të drejtuar politikën e vendit karshi vendeve të tjera dhe më bashkësinë e gjerë botërore dhe vetvetiu është shprehje e fuqisë së ndikimit të vendit. Niveli i organizimit dhe funksionimit të tij e bën atë si faktor kyç gjeopolitik për vendin. Fuqia e këtij mjeti gjeopolitik njëherësh është e kushtëzuar nga rrjedhat shoqërore politike, përkatësisht stabiliteti dhe qëndrueshmëria e atyre rrjedhave të kohës në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Më interes për fushën gjeopolitike, përkatësisht për vetë gjeopolitikën si shkencë, është njohja dhe të kuptuarit e politikës si "politikë e lartë" ose "politikë e madhe", e cila preokupohet me "çështje të mëdha për interesa të larta" (ushtarake, politika të sigurisë, politika ndërkombëtare, apo marrëdhëniet ndërkombëtare, ose politika të jashtme e shteteve etj.), të cilat kanë qenë objekt studimi i autorit të këtij libri, Hamz Lladrovci, në librin e tij me titull "Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe (1856-2018)".

Si e veçuar nga e ashtuquajtura "politikë e madhe" konsiderohet "politika e jashtme e vendit" me mjetin e saj diplomatik si mjet gjeopolitik, e cila njëherësh është edhe determinuese e fuqishme gjeopolitike, sepse edhe vetë gjeopolitika si gjeopolitikë praktike në kuptimin e vet reflekton si, "raport, marrëdhënie midis vendeve apo shteteve si subjekte të së drejtës ndërkombëtare".

Rrethanat dhe kushtet e ngritjes dhe të ndërtimit të politikave në vazhdimësi kanë evoluuar, duke i dhënë atyre pamje dhe dimension të ri. Niveli i lidhjes së politikave dukshëm ka ndryshuar, duke i dhënë konfigurim të ri atyre e më këtë edhe vetë shtetit si "lidhje e politikave".

Në procesin e lidhjeve politike (si lidhje në dinamikën e tyre) aktorët i kanë ndërruar pozicionet dhe fuqinë e veprimit ndaj atyre proceseve, vetëm së shteti edhe më tej ka mbetur aktori kryesor në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Në favor të kësaj fuqishme qëndron thënia e Aleksander Dugin (gjeopolitikanit të njohur rus) "prostorno mislit", që në kuptim të

thjeshtë është një mesazh i fuqishëm për të mos larguar asnjëherë mendjen nga hapësira. Pra, nga kjo kohë në Europë zë fill një koncept i ri në rregullimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, që u krijua në Europë me Konferencën e Parisit të vitit 1856 dhe njihet me nocionin e ashtuquajtur: "Koncerti i Europës", që në fakt ishte si një koncept gjeopolitik, sipas të cilit: "problemet ndërkombëtare do t'i zgjidhnin bashkërisht Fuqitë e Mëdha Europiane", pa marrë parasysh formën e qeverisjes në ato shtete.

Autori Hamz Lladrovci këtë koncept, këto shkaqe dhe këtë gjeopolitikë të krijuar në Europë me Konferencën e Parisit të vitit 1856 e ka përfshirë në mënyre shumë të detajuar dhe shkencore në këtë libër. Ai poashtu njeh dhe i shtjellon më një përgjegjësi shkencore të gjitha këto rrethana gjeopolitike të krijuara në marrëdhëniet ndërkombëtare në kontekstin gjeopolitik, karakteristike për këtë fazë është së në shtrirjen graduale të politikës, ku kemi shtrirjen: "E frymës "liberale demokratike", por, edhe të: "Synimeve ekspansioniste të shteteve të mëdha të Europës mbi ato të voglat.

Mbi bazën e kësaj politike, filluan pushtime të reja dhe u krijuan kushte për një "ndarje të re të botës" midis Fuqive të Mëdha të Europës. Kështu, nga viti 1876 -1900, të gjashtë fuqitë e mëdha të Europës zgjeruan hapësirat e tyre gjeografike nga 40 milionë kilometra katrorë, në 65 milionë kilometra katrorë.

Në gjithë këtë vorbull dhe turbulencë gjeopolitike jo pa ndikim ka qenë vetë Rusia, roli i së cilës ka reflektuar në rrjedhat dhe proceset që ndërlidhen me Ballkanin e në veçanti me gjeohapësirën shqiptare. Për këto vlime gjeopolitike ka dhe ka pasur shkrime të bollshme, por sikurse çdo here autorët dhe studiuesit e shumtë i kanë shtrembëruar, duke u shendruar në vegël të interesave të pushteteve prej nga ata vijnë.

Nga kjo edhe duhet parë motivimin e autorit të librit me titull "Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe (1856-2018)", të studiuesit Hamz Lladrovci, punim i cili njëherit është edhe vazhdimësi dhe thellim e zgjerim i punimit të masterit, më të njëjtin titull.

Është për tu përhëndetur guximi intelektual i autorit të librit Hamz Lladrovci, që t'irreket më zgjuarsit dhe vëmendje këtij problemi të ndeshem për shkencën por edhe për politiken përkatësisht gjeopolitiken aktuale të Ballkanit të rajonit por edhe atë globale, për faktin së fuqia gjeopolitike ruse e humb kuptimin pa ndikimin dhe

influncën në Ballkan në përgjithësi dhe në veçanti mbi hapësirën gjeografike shqiptare.

Periudhën të cilën e ka përzgjedhur autori është periudhë e vlimeve të mëdha, që për synim kishin shembjen e perandorive në njërin anë, dhe krijimin e shteteve kombëtare në anën tjetër.

Kjo periudhë e sidomos nga viti 1878 e këndeje deri me sot ishte koha kur populli shqiptar synoi u përpoq por edhe luftoi në mënyre të vazhdueshme që të arrijë çlirimin dhe synimin e çlirimit dhe emancipimit kombëtar nga Perandoria Osmane dhe për t'u bërë zot i trojeve të veta. Ishte periudhë e përplasjeve të mëdha gjeopolitike në Europë për ndikim dhe zgjerim të territoreve të shteteve të mëdha europiane, andaj edhe gjithë kjo periudhë duhet parë dhe kuptuar ekskluzivisht në kontekstin gjeopolitik të saj.

Autori Hamz Lladrovci, librin e tij e fillon më një vështrim historik genealogjik dhe etnohistorik të formimit të popullit rus dhe të Shtetit të Rusisë, duke u shërbyer edhe me gjeopolitikën e kaluar si metodë gjeopolitike për njohjen e gjeopolitikës së re, përkatësisht të periudhës nga viti 1856 deri në ditët e sotme, periudhë kjo e cila është edhe objekti i studimit.

Gjeohapësirën ruse e paraqet si gjeografi politike mjaftë të shpërndarë mbi bazën kulturore etnike e demografike, jokompakte, më raporte të ulta e primitive që nuk janë me tipare njerëzore, sikurse është rasti me fisin sllav "Samojedën", që kishte më tipare kanibaliste.

Një gjeografi politike e tillë siç e përshkruan autori më aq diversitete të mëdha nuk ka mundur të jete me fuqi ndikimi për rajonin dhe më gjerë rrafshin global, tek më vonë gjeohapësira ruse gradualisht do të paraqitet si gjeohapësirë më fuqi ndikimi në rrethin e afërt dhe të largët.

Përderisa bota e perëndimit në shkollat e saja gjeopolitike e zhvillonte idenë e hapësirës jetike si burim të fuqisë së shtetit, me çka e ushqen idenë e zgjerimit të hapësirës, bota kontinentale në zemër të të cilës gjendej Rusia, fuqinë e vete gjeopolitike e shihte në politikën pansllaviste, në emër të të cilave i arsyetonte pretendimet e veta drejtë forcimit dhe mbështetjes për sllavet e jugut.

Autori më një përkushtim dhe mprehtësi të sensit shkencor trajton çështjen shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe, që paraqet edhe thelbin e studimit.

Ofensiva diplomatike, ushtarake dhe gjeopolitike ruse fillon në kohën kur, fuqia e Perandorisë Osmane

fillon të bie, pas humbjes që pësoi pas thyerjes së saj në rrethimin dhe jetëveçar të Vinës në vitin 1683 ku me dështimin e këtij rrethimi u lidh Paqa e Karlovic me 1699.

Pretendimi i përhershëm i Rusisë ka qenë dalja në ujera të nehta përmes Adriatikut, sepse me Traktatin e Parisit të vitit 1856 dhe më konceptin gjeopolitik "Koncerti i Europës", e kishte shpallur si det neutral e të demilitarizuar Detin e Zi.

Në fuqinë e ndikimit sipas autorit do të ndikojnë edhe Traktati i Shën Stefanit (03.03.1878) dhe po atë vit edhe Traktati i Kongresit të Berlinit (1878), duke ndikuar në rritjen e territoreve të shteteve sllave në Ballkan e në dëme të territorit shqiptar i cili vazhdimisht t'kurej.

Në gjithë këtë katrahurë gjeopolitike e diplomatike midis shteteve të Ballkanit sikurse konstaton autori, shqiptaret nuk ndejnë duarkryq por patriotet shqiptar nga Stambolli përmes Memordumit të tyre, i dërguan Kongresit të Berlinit më 1878 kundërshtitë e tyre për copëtimin e trojeve shqiptare. Poashtu zëri atdhetar shqiptar nga Rilindësit tanë u dëgjua edhe përmes zërit të pushkës, pra përmes kryengritjes të shumta të armatosura duke luftuar dhe kërkuan liri dhe pavarësi ashtu sikurse popujt tjerë të kësaj gjeohapësire të Ballkanit, por mjerisht vazhdimësi këto liri dhe të drejta kombëtare shqiptare e nuk u përfillen nga qendrat vendimmarrëse të Europës që nga Kongresi i Berlinit 1878 e deri te Pakoja e Ahtisarit.

Hamz Lladrovci në librin e tij, ndalet dhe trajton edhe komponentin gjeostrategjike, sidomos atëherë kur trajton rrethanat politike dhe ushtarake në luftërat ballkanike duke e prezantuar rolin e mjetit diplomatik si diplomacie fshehtë ruse, për faktin së ajo në të njëjtën kohë ishte rivale dhe një diplomaci e fshehte kundër fuqisë së kohës si ishte Perandoria e Austro-Hungarisë, por në radhë të parë edhe kundër Perandorisë Osmane, pra duke e përgatitur kështu fshehtas dhe hapur interesat dhe gjeopolitiken pansllave.

Nga kjo duhet parë edhe rolin e Rusisë në formimin e Aleancës Ballkanike, e cila aleance ishte edhe kundër interesave të popullit shqiptar dhe për copëtimin e trojeve shqiptare. Prandaj edhe shpallja e pavarësisë së Shqipërisë më 1912, nuk u prit mirë as nga shtetet ballkanike dhe as nga Rusia cariste.

Mjaftë bukur autori Lladrovci e trajton edhe Konferencën e Ambasadoreve në Londër në vitin 1912/13, ku autori e përshkruan edhe përplasjen dy botërore, Tabori gjermanofon në krye më Austro-Hungarinë dhe tabori pansllav në

krye më Rusinë cariste.

Në kontekstin gjeopolitik, më forcimin fuqisë së ndikimit të Austro-Hungarisë drejt jugut nënkuptonte ndërprerjen e rritjes së fuqisë së ndikimit nga lindja prej Rusisë që ishte si pengesë e daljes së saj në Adriatik.

Atë që nuk kishte mund të arrij Rusia më luftërat ballkanike 1912/1913 dhe më luftën e parë botërore (1914-1918), ja arrin në kohën e Enver Hoxhës sidomos gjatë dhe pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ku Shqipëria rreshtohet në kampin e llagert socialist të udhëhequr nga Stalini.

Këtë periudhë të raporteve Rusi - Shqipëri, sidomos periudhën Stalin-Enver dhe Hrushov-Enver, autori Hamz Lladrovci e përpunon dhe e shtjellon mjaftë seriozisht dhe më Competence shkencore.

Një kapitull të veçantë dhe më mjaftë kujdes, ai e trajton edhe rolin e Federatës Ruse, si dhe qëndrimin zyrtar të Rusisë së sotme të Putinit përball shtetit të Kosovës, shpalljes së pavarësisë dhe rrugëtimit të Kosovës si shtet për të për të përfituar njohjet ndërkombëtare dhe anëtarësimin e saj në OKB dhe organizata të tjera publike ndërkombëtare.

Në këtë çështje Rusia e sotme e Putinit paraqitet mjaftë agresive dhe negative duke përkrahur dhe mbështetur çdo program serb e anti shqiptar.

Librin e tij Hamz Lladrovci e përfundon më shqyrtime përfundimtare duke i përmbledhur çështjet të cilat i ka parashtruar si objekt hulumtimi dhe trajtimi shkencor.

Marrë në përgjithësi, më aplikimin e një rigoroziteti shkencor dhe ndershmërie akademike autori Hamz Lladrovci, ja ka arritur që të japë një kontribut të rëndësishëm në studimin e problemit të parashtruar më titull: "Çështja Shqiptare përballë diplomacie dhe gjeopolitikës rusomadhe të viteve 1856-2018", si dhe të publikoj në studimin të thellësishtëm të gjeopolitikës dhe diplomacisë rusomadhe, në raport më shqiptaret dhe çështjen shqiptare për liri pavarësi dhe bashkim të trojeve të tyre!



EURO GLASS
SAINT-OBISAN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SLOVENIA - BULGARIA

1

WALES - IRELAND

1

GERMANY - FRANCE

1

Kosova shkon të korrë fitore në Azerbajxhan



Në ndeshjen e parë në Ligën e Kombeve më 7 shtator, Kosova, e drejtuar nga Bernard Challandes, kërkon fitore. Përfaqësuesja të mërkurën e ka zhvilluar përgatitjen e fundit në stadiumin "Fadil Vokrri", kurse sot (e enjte) niset drejt Bakus. "Kemi një kundërshtar mjaft të fortë e me agresivitet. Dua të kemi një ekip të mirë. Nuk jam i fokusuar në individë. E di që të gjithë kanë dëshirë të luajnë, por ne duhet ta dimë se kemi dy ndeshje dhe duhet të kemi lojtarë për dy ndeshje. Do të bëjmë atë që mundemi më së miri", ka thënë Challandes

për ish-presidentin Vokrri", ka thënë portieri Ujkani.

Përfaqësuesja vizitohet nga ministri Gashi dhe delegacioni i SIGA-s

Përfaqësuesen të mërkurën e vizituan ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, dhe delegacioni i SIGA-s. Trajneri i Përfaqësueses, Bernard Challandes, e njoftoi ministrin Kujtim Gashi se lojtarët janë në gatishmëri të plotë për përballje kundër Azerbajxhanit, duke treguar se synim janë pikët e plota. Ministri i premtoi përkrahjen dhe i dëshiroi suksese Përfaqësueses në garat e Ligës së Kombeve. Delegacioni i SIGA-s, i shoqëruar nga drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, presidenti Besim Hasani dhe sekretari i përgjithshëm, Shasivar Haxhijaj, vizituan Përfaqësuesen e Kosovës gjatë stërvitjes në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Delegacioni i UEFA-s u njoftua me procesin e rinovimit të stadiumit, i cili tek në javën e kaluar mori licencën e UEFA-s për kategorinë e katërt, derisa u uruar djelmoshave të përfaqësueses suksese në dy ndeshjet e radhës.

FFK-ja: Biletat sot dalin në shitje në pikat e IPKO-s

Federata e Futbollit e Kosovës kishte paralajmëruar se biletat do të dalin në shitje të mërkurën, por kjo nuk ndodhi për shkak se FFK-ja kishte planifikuar shitjen e biletave në pikat e "Zmobile". Të mërkurën Federata mori vendim të ndërrohen pikat e shitjes për shkak se sponsor i saj është IPKO. Adhuresit që dëshirojnë të pajisen me biletat mund të bëjnë një gjë të tillë të enjten në mesditë në pikat e shitjes së IPKO-s.

SHKURT

Ismajli i bashkohet Përfaqësueses U21

Federata e Futbollit të Kosovës ka njoftuar se Ardijan Ismajli do të jetë pjesë e Përfaqësueses së Kosovës U21. Sipas FFK-së, kjo është bërë në koordinim në mes të trajnerëve të përfaqësuesve. Ardijan Ismajli do t'u ndihmojë U21-shave në ndeshjen kundër Irlandës, ndërkaq nga e shtuna Përfaqësueses A do t'i bashkohet futbollisti Besar Halimi.

Mavraj transferohet tek Arisi

Reprezentuesi i Shqipërisë në futboll, Mërgim Mavraj, ka nënshkruar kontratë me skuadrën e Arisit. Lajmin për realizimin e këtij transferimi e ka bërë me dije për mediet greke presidenti i Arisit të Selanikut, Theodor Karipidis. Mavraj në klubin e ri do ta ketë shokë skuadre Migjen Bashën. 32-vjeçari ka luajtur për Hamburgun, Kolnin, Bochumin, Greuther Furth dhe Darmstadt 98.

Minnisi, amerikani i katërt në KB Rahovec

KB Rahoveci e ka realizuar edhe transferimin e katërt të huaj në këtë afat kalimtar. Bëhet fjalë për amerikanin Deshon Minnis, i cili luan në pozitën një. Minnis ishte pjesë e disa skuadrave në rangje të kolegeve në ShBA, ndërsa NCCA divizioni 1 ishte liga që i njëjti ka luajtur pjesën më të madhe gjatë karrierës së tij, konkretisht në Philadelphia Stars.

Mazrekaj, afër Flamurtarit

Futbollisti Mentor Mazrekaj është afër t'i bashkohet skuadrës së Flamurtarit në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. "Olle" raporton se ish-lojtari i Prishtinës ka zhvilluar një takim me trajnerin e Flamurtarit, Arsim Thaqin. Gjasat që ai ta veshë fanellën kuqezi janë të mëdha. Skuadra nga kryeqyteti është lidere pas xhiros së tretë në elitë.

EPOKA E RE

Liridon ZEQRIRI

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka zhvilluar të mërkurën përgatitjen e fundit para udhëtimit në Baku. Ekspedita e Kosovës udhëton sot (e enjte) drejt Azerbajxhanit për ta zhvilluar lojën e parë në Ligën e Kombeve, e cila është paraparë të zhvillohet më 7 shtator në Baku.

Trajneri i Kosovës, Bernard Challandes, ka thënë se kundërshtari ka një skuadër cilësore, por që Kosova synon të japë dhe marrë më të mirën në këtë ndeshje. "Unë dhe shtabi teknik kemi punuar mjaft këto ditë si në mbrojtje, mesfushë dhe sulm. Kemi ushtruar lojën presing, guajtjet e lira, nga këndi dhe pika e bardhë. Kemi një kundërshtar mjaft të fortë e me agresivitet. Dua të kemi një ekip të mirë dhe nuk jam i fokusuar në individë. E di që të gjithë kanë dëshirë të luajnë, por ne duhet të dimë se kemi dy ndeshje dhe duhet të kemi lojtarë për dy ndeshje. Do të bëjmë atë që mundemi më së miri", ka thënë trajneri zviceran.

Ndërsa mesfushori i skuadrës Start, Herolind Shala, është i bindur se përfaqësuesja mund të marrë një rezultat të mirë në Azerbajxhan. "Gjatë këtyre ditëve jemi përgatitur maksimalisht e këtë na e kanë mundësuar edhe

kushtet e mira. Kemi motiv dhe disponim të mirë. Kjo besoj do ta japë edhe rezultatin e favorshëm për ne. Unë shpresoj se kemi gjasa jashtëzakonisht të mira për të shkuar tutje", ka deklaruar ai.

Para udhëtimit për Baku foli edhe mbrojtësi që aktivizohet te skuadra e Dinamo Zagrebit, Amir Rrahmani. Ky i fundit ka treguar se është gati ta jap maksimumin për Kosovën. "Përgatitjet po shkojnë mirë. Do t'i kemi edhe dy stërvitje deri në ndeshjen kundër Azerbajxhanit dhe e dimë çfarë duam. Jemi plotësisht të koncentruar dhe besoj se do të dalim fitues dhe jemi të vetëdijshëm që vendi i parë në grup shkon tutje. Jam i gatshëm ta jap kontributin tim maksimal", ka potencuar ish-mbrojtësi i Drenicës.

Si zakonisht, optimist është shfaqur edhe kapiteni dhe numri një në portën e Kosovës, Samir Ujkani. Ai ka bërë me dije se ky i fundit dëshiron fitore për legjendën e futbollit dhe ish-presidentin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri, i cili ka ndërruar jetë muaj më parë. "Jemi përgatitur maksimalisht këto ditë, sepse nuk ka kundërshtarë të lehtë. Azerbajxhani ka një skuadër të mirë, por ne do të përpiqemi ta japim maksimumin tonë të dijës dhe forcës që të dalim faqebardhë nga kjo ndeshje. Ekziston motiv i dyfishtë për neve: do të luajmë për fitore dhe

Hysaj: Mund ta mposhtim Izraelin

TIRANË, 5 SHTATOR - Mbrojtësi i Napolit, Elseid Hysaj, është ndër pikat më të forta në kombëtaren e Shqipërisë. Ai ka thënë se kuqezinjët mund ta mposhtin Izraelin në ndeshjen që zhvillohet në Elbasan në kuadër të

Ligës së Kombeve. "Nuk duhet të mendojmë të kaluarën dhe duhet të jemi të qetë. Të fokusohemi te kjo mundësi që kemi për të shkuar në Evropian. Jemi stërvitur mirë dhe jemi gati. E kemi kuptuar se janë ndeshje

zyrtare dhe jo miqësore. Ne nuk duhet t'i falim minuta Izraelit siç bëjmë këtu ndeshjen e parë. Kishim mundësi t'i fitonim të dyja ndeshjet. Ajo që duhet të bëjmë tani është përqendrimi. Kemi një trajner të ri dhe

mendime të reja. E dimë ku duhet të përmirësohemi. Të gjithë duhet të kemi një gjë në tru, kualifikimin në Evropian. Do të ishte një gjë e madhe dhe entuziazmi nuk na mungon", ka thënë Hysaj.



Ministri Gashi: Epoka e re e sportit po ndodh

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, mori pjesë në Samitin Rajonal për Integritetin në Sport, i cili po mbahet në Kosovë, nën organizimin e Aleancës Globale të Integritetit për Sport (SIGA) dhe Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK). Kjo ngjarje organizohet për herë të parë në Prishtinë. Ministri Gashi ka vlerësuar përkushtimin dhe punën e jashtëzakonshëm të Emanuel Macedo de Medeiros, drejtorit të SIGA-s, duke mundësuar që misioni dhe mesazhi i SIGA-s mbi Standardet Universale të Mirëqeverisjes të përcillet globalisht edhe nga Prishtina. "E përgëzoj edhe Besim Hasanin, president i Komitetit Olimpik të Kosovës, që u bë ambasadori i vendit tonë, që me përkushtimin e tij ka bërë që ky Samit të na mbledhë të gjithëve në Prishtinë dhe të flasim për integritetin në sport dhe sfidat konkrete të zbatimit në realitet. Komiteti Olimpik Kombëtar i Kosovës dhe Aleanca Globale për Integritet në Sport na bashkojnë më së miri sa i përket interesit për mirëqeverisjen në sport dhe vizionin drejt së ardhmes", ka thënë ministri Gashi.

Ministri ka folur për punën dhe politikën që ndjek për fushën e sportit. "MKRS është e angazhuar dhe po zbaton një proces strategjik të qeverisjes së sportit në Kosovë



dhe ky proces po ndeshet me sfidat e menaxhimit të ndryshimit, por edhe po mbështetet nga një vullnet i madh i institucioneve dhe partnerëve qendrorë, lokalë e ndërkombëtarë dhe vepra të shumta me rëndësi strategjike për sportin janë konkretizuar dhe vijnë të kryhen. Këto realizime së bashku me rezultatet e shkëlqyeshme të sportistëve tanë modelistë botërorë, olimpikë dhe me radhë, shënojnë themele të forta për vazhdimësinë afatgjatë", ka deklaruar Gashi.

Ministri ka përmendur se MKRS-ja angazhohet dhe është në shërbim të brezave të tashëm dhe të ardhshëm, duke përgatitur dokumentet e duhura e moderne ligjore

të cilat mundësojnë zhvillimin dhe integritetin në sport. "Një bazë ligjore të përditësuar kundër dhunës në sport, Ligji për Sponsorizime, rregulloret dhe udhëzimet ligjore të miratuara, që kanë të bëjnë me kategorizimin e sportistëve, mirëqeverisjen dhe infrastrukturën e më gjerë, janë pjesë e punës konkrete të realizuar, që të mundësojnë zhvillim dhe integritet në sport për të gjithë në Kosovë dhe në rajon e më gjerë", ka shtuar ai.

Ministri për fund theksoi se Kosova është në rrugën e duhur me shumë energji pozitive dhe fakti që sot në Kosovë po zhvillohet ky samit tregon se epoka e re e sportit po ndodh.

Stephens eliminohet nga US Open, kualifikohet Rafael Nadali

LONDËR, 5 SHTATOR - Surpriza e radhës së US Openit e ka emrin Sloan Stephens. Kampionia në fuqi e turneut u eliminua në fazën çerekfinale pasi u mposht nga Sevastova, numri 19 i renditjes botërore. Tenista letoneze u shfaq superiore ndaj Stephensit në ndeshjen me të cilën e fitoi 2-0 pas 1 orë e 24 minutave lojë me sete 6-2; 6-3. Në gjysmëfinale Sevastova do të përballlet me një tjetër amerikane, Serena Williamsin. Kjo e fundit eliminoi në çerekfinale Karolina Pliskova teksa e mundi atë me rezultatin 2-0. 6-4; 6-3 ishte rezultati i seteve të fituara nga Serena Williamsi, e cila e shih veten vetëm dy ndeshje larg titullit të saj të parë Grand Slam në statusin e nënës. Në kampin e meshkujve, Rafael Nadali dhe Dominic Thiem u bënë protagonistë të një ndeshjeje epike që zgjati 4 orë e 49 minuta, ku fitues



në fund doli pikërisht spanjoll 3-2. Fillimi i sfidës ishte katastrofik për Nadalin që humbi setin e parë 0-6, por numri 1 i botës reagoi dhe përmbysi situatën duke marrë kryesimin në 2-1, pasi fitoi setin e dytë e të 3 6-4; 7-5. Thiem iu kundërpërgjigj në të kartën që e fitoi me tiebreak 7-6. Tiebreaku

zgjidhi edhe setin final që shkoi për Nadalin, i cili në gjysmëfinale do të luajë me Juan Martin del Potron. Argentinasi mundi amerikanin John Isner për të qenë mes 4 më të mirëve të turneut. 3-1 ishte rezultati me të cilin Del Potro e fitoi këtë ndeshje me sete 6-7; 6-3; 7-6; 6-2.

SHKURT

Neueri: E mirëseardhur ndeshja me Francën

Gjermania do të luajë kundër Francës në ndeshjen e parë pas dështimit në Botërorin "Rusi 2018. "Gjëja më e mirë është të luajmë menjëherë kundër një skuadre kaq të mirë. Duam të tregojmë se çfarë mund të bëjmë", ka thënë kapiteni i Gjermanisë, Manuel Neuer. "Duam ta luajmë futbollin më të mirë kundër kampionëve të botës. Duam ta shijojmë të luajmë përsëri. Do të jetë një detyrë e vështirë, por ne duam të fitojmë në shtëpi. Stadiumi do të jetë i mbushur plot dhe kjo është një shenjë e mirë se njerëzit duan të na shohin të luajmë përsëri. Do të japim gjithçka për t'i bërë të lumtur", ka deklaruar Neueri.

Pogba: Dua të luaj për Zidanen

Mesfushori Paul Pogba ka rrëfyer për të përditshmen britanike "The Sun" se ëndrra e tij është që një ditë të ketë si trajner idhullin e tij të fëmijërisë, Zinedine Zidane. Burime nga skuadra e Unitedit shprehen: "Pauli është rritur duke pasur Zidanen hero dhe të luajë për të është ëndrra e tij më e madhe. Ai edhe mund të ishte transferuar te Reali para dy vjetësh, por dëshironte Manchester Unitedin. Ata të dy kanë thuar se të njëjtin stil loje, ndaj është rritur duke e parë se si luan, duke mësuar prej tij".

Suarezi: Barça mund ta fitojë Ligën e Kampionëve

Sulmuesi i Uruguait, Luis Suarez, beson se Barcelona mund ta fitojë Ligën e Kampionëve. Sipas tij, Barça i ka të gjitha elementet për të bërë një gjë të tillë. "Me trajnerin dhe kualitetin e ekipit mund ta fitojmë Ligën e Kampionëve", ka deklaruar Suarez.

Griezmanni: Shpresoj të jem në podium për 'Topin e Artë'

Prej vitesh Antoine Griezmann ka marrë rolin e protagonistit tek Atletico e Madridit, ndërsa 2018-a ka qenë vërtet e artë për të, pasi triumfoi me madrilënët në Evropa Ligë, ngrii Kupën e Botës "Rusi 2018" me Francën dhe fitoi edhe Superkupën e Evropës, sërisht me Atletico. Gjithsesi të gjitha këto nuk mjaftuan që futbollisti të jetë pjesë e finaleve së përzgjedhjes së futbollistit më të mirë të vitit nga ana e UEFA-s dhe FIFA-s. "Jam shumë i zhgënjyer, pasi Franca fitoi kupën e Botës dhe në përzgjedhjen finale të FIFA-s nuk është asnjë francez kandidat për futbollistin më të mirë të vitit. Shpresoj që, të paktën, të jem pjesë e podiumit të 'Topit të Artë', të organizuar nga France Football", ka thënë Griezmann.

Pritet të ndryshohet rregulli i golit në fushën kundërshtare

UEFA është e hapur për ta ndryshuar golin në fushën kundërshtare sa iu përket garave evropiane. Sekretari i përgjithshëm i institucionit më të lartë të futbollit në Evropë, Xhorxho Marketi, u shpreh se kjo është një dëshirë e trajnerëve. "Trajnerët mendojnë se ky rregull duhet rishikuar dhe kjo është ajo që ne do të bëjmë. Megjithatë ky rregull është më pak i komplikuar në krahasim me të kaluarën", ka thënë Marketi. Në këtë takim morën pjesë trajnerët: Allegri, Ancelotti, Tuchel dhe Lopetegui. Ata mendojnë se rregulli i golit në transfertë nuk sjell produktivitet, sepse ekipet që luajnë jashtë duhet të sulmojnë dhe ato që janë në shtëpi, të mbrohen. Ky rregull u aplikua në Ligën e Kampionëve në vitin 1965, ku zëvendësoi përsëritjet e ndeshjeve. Një gol në fushën kundërshtare vlen shumë në ndeshjet me eliminim direkt, pasi në shtëpi ai llogaritet sa për 2.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opštine Dragaš / Daraqas Municipality



Mbështetur në Nenin 5, pika c, të Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 8 pika 1,2 të Ligjit të punës Nr.03/L-212 dhe kërkesave të drejtorit të DKA-së në Dragash me nr.02.111/1-21853 dhe nr.02.111/1-21864, aprovimet nga kryetari i Komunes së Dragash-it Shërbimi i Personelit K.Dragash shpallë:

KONKURS

*Për plotësimin e vendeve të
lira të punës:*

• **Dy punëtor teknik-pastrues**

*Nje në SHFMU "Ilmi Bahtjari" në paralelen e ndarë fizike në fsh.Blaq dhe
Një në SHFMU "Fetah Sylejmani" në paralelen e ndarë fizike në fsh.Rrenc*

- **Niveli i pages; K 4**
- **Periudha e kontrates; 12 muaj me mundësi vazhdimi**
- **Vendi i punës; SHFMU "Ilmi Bahtjari" fsh. Blaq-Dragash (njëra pozitë) dhe SHFMU Fetah Sylejmani në fsh.Rrenc-Dragash**
- **Oret e punës; 40 ore ne javë**
- **Pergjegjes mbikqyrës ;drejtori i shkolles**

Kushtet për punëtor teknik :

Kandidatët e interesuar për të konkurruar për vendin e punës, **Punëtor teknik-pastrues** duhet t'i plotësojnë këto kushte:

Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës

Të kenë të kryer shkollën e mesme .

Detyrat e punës për punëtor teknik-pastrues, do të caktohen me kontratë të punës.

Aplikacionet merren në zyrën e Personelit –K.Dragash.

Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet: Letërnjoftimi, ekstrakti i lindjes, diploma fotokopje e vërtetuara te noteri.

Dokumentet e pa kompletuara nuk merren në shqyrtim.

Afati i konkurrimit është **15 ditë** nga dita e publikimit në gazet.

Sherbimi i Personelit
Dragash



REPUBLIKA E KOSOVËS
Medreseja e Mesme "Alauddin" Prishtinë
Medressah "Alauddin" Islamic High school
مدرسة "علاء الدين" الثانوية

Nr. 217/18

Prishtinë, më 05.09.2018

Medreseja e Mesme "Alauddin" në Prishtinë, shpall:

KONKURS

Për vendin e punës – Kuzhinjer

Të interesuarit duhet ti plotësojnë këto kushte:

- Të kenë të kryer shkollën e mesme dhe kualifikimin-diplomën për kuzhinjer.
- Të kenë cilësi morale-fetare.
- Të jenë të shëndoshë fizikisht dhe psikikisht.
- Të mos jenë të denuar dhe nën hetime.
- Ti përmbahen kushteve dhe specifikave që i ka shkolla.
- Të kenë përvojë pune, në detyrën e kuzhinjerit, 3 vite.

Dokumentet e kërkuara:

- Kërkesa për punësim.
- Diploma e shkollës së bashku me diplomën për kualifikim.
- Çertifikata e lindjes.
- Çertifikata shëndetsore.
- Çertifikata se nuk është nën hetime ose i denuar.
- Deklaratën se do ti përmbahen kushteve-specifikave të shkollës.
- Dëshmin e përvojës së punës.
- Të gjitha dokumentet duhet të jenë në original.

Dokumentet dorëzohen në drejtorinë e shkollës në afat prej 7 ditësh nga dita e shpalljes.



Adresa: R. "Xhemajli Ibishi" p.n. Prishtinë, Tel & Fax. --381 38 224 444



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opštine Dragaš / Daraqas Municipality



Na osnovu člana 5, tačka c Zakona br. 03 / L-068 o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo, kao i člana 8 tačka 1.2 Zakona o radu br.03 / L-212 i zahtevi direktora ODO-a u Dragašu br. 02.111 / 1-21853 i br.02.111 / 1-21864, odobrenja od strane gradonačelnika opštine Dragaš, Kadrovska služba O.Dragas objavljuje:

KONKURS

O popunjavanju slobodnih radnih mesta:

• **Dva tehnička radnika-cistaca**

Jedan u OSNS "Ilmi Bahtjari" istureno odeljenje u selo Blac

Jedan u OSNS "Fetah Sylejmani" istureno odeljenje u selo Rrence

- **Nivo plate; K 4**
- **Period ugovora; 12 meseci sa mogućnošću produženja**
- **Radno mesto; Jedan u OSNS "Ilmi Bahtjari" istureno odeljenje u selo Blac i drugi u OSNS "Fetah Sylejmani" istureno odeljenje u selo Rrence**
- **Radni sati: 40 casa nedeljno**
- **Nadleyno lice: Direktor škole**

Uslovi tehničkog osoblja:

Kandidati zainteresovani za prijavu za posao, tehničko osoblje, čistač, mora ispuniti sledeće uslove:

Da budete državljani Republike Kosovo

Da ima završenu srednju školu.

Dužnosti tehničkog osoblja- čistač će biti određene ugovorom o radu.

Aplikacije se uzimaju u kancelariji Kadrovske službe -O.Dragas.

Aplikaciji se prilažu dokumenti: lična karta, ekstrakt rođenih, fotokopija diploma sertifikovana od strane notara.

Nepotpuna dokumenta se neće razmatrati.

Rok za konkurs je 15 dana od dana objavljivanja u novinama.

Kadrovska služba O.Dragas

NJOFTIM

Shuarje e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "DENTAL" SH.P.K. me seli në PRISHTINË me çertifikatën e regjistrimit Nr. I Bizensit. 70600617, Nr. Fisc. 600002167, Nr.TVSH. 3012537, Konform nenit 107, paragrafi 1 të Ligjit për Shoqërit Tregëtare themeluesit e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar DENTAL sh.p.k. ARBEN HASANGJEKAJ nga PRISHTINA, me Nr. Personal 1011019672 dhe LIRIM AZIZI nga PRISHTINA me Nr. Personal 1001109116 shpallin : Të mbyllur - shuajnë shoqërinë "DENTAL" SH.p.k. Nr. I Bizensit. 70600617 Nr. Fis. 600002167 Nr.TVSH. 3012537 dhe kërkojnë nga të gjithë të interesuarit, që kanë ndonjë kontest ose kërkesë ndaj kësaj shoqërie, të paraqesin kërkesën pranë themeluesve, në afatin mbrenda 30 ditëve nga dita e publikimit e kësaj shpallje në gazetën ditore "EPOKA E RE" në Prishtinë."DENTAL" sh.p.k. me seli në PRISHTINË me pronar ARBEN HASANGJEKAJ dhe LIRIM AZIZI, emrojnë Likvidator ENVER BERISHA Tel: 049 – 301 009

ANNOUNCEMENT

Close of limited liability company "DENTAL" LLC, based in PRISHTINA, with the registration certificate, Business Nr. 70600617, Fis.Nr. 600002167, VAT Nr.3012537, According to article 107, paragraph 1 of Kosovo Business Law limited liability company "DENTAL" LLC, ARBEN HASANGJEKAJ from PRISHTINA, with personal ID Nr. 1011019672 and LIRIM AZIZI from PRISHTINA, with personal ID Nr. 1001106119 declared: Society of closed "DENTAL" LLC and require all stake holders, who have a claim against the contest or company present the request to the founders, within 30 days of publication of this ad in the daily "EPOKA E RE" in Prishtina.

"DENTAL" LLC based in PRISHTINA owner ARBEN HASANGJEKAJ and LIRIM AZIZI name the likvidator ENVER BERISHA Tel: 049 – 301 009

OBAVESTENJE

Zatvaranje – Gasenje Društva sa ograničenom odgovornošću "DENTAL" D.O.O. sa sedistem u PRISTINA, u Uverenje o Registraciji, Br.biznisa. 70600617, Fisc.Br. 600002167, PDV. Br. 3012537, Na osnovu člana 107, tačka 1 Zakona o Privrednim Društvima, osnivači društva sa ograničenom odgovornošću "DENTAL" D.O.O. ARBEN HASANGJEKAJ, iz PRISTINE, sa personalnim br. 1011019672 i LIRIM AZIZI, iz PRISTINE sa personalnim br. 1001106119 oglašavaju zatvorenim – ugasenim društvu sa ograničenom odgovornošću "DENTAL" D.O.O. I traže od svih zainteresovanih lica u slučaju da imaju neke nesuglasice ili neke potraživanja prema Društvu "DENTAL" D.O.O. da se obrate osnivačima u roku od 30 dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi "EPOKA E RE" iz Pristine.

"DENTAL" D.O.O. sa sedistem u PRISTINA osnivači ARBEN HASANGJEKAJ i LIRIM AZIZI, likvidator ENVER BERISHA Tel: 049 – 301 009



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës
Ministarstvo Infrastrukture
Ministry of Infrastructure

SHPALLJA E REKRUTIMIT Oglas za regrutiranje

Institucioni: **Ministria e Infrastrukturës**

Institucija: **Ministarstvo Infrastrukture**

Institucioni/institucija **MI/MI** kërkon të punësojë (titullin e pozitës)

në (departamentin/drejtoratin/divizionin,njësinë) e /zeli da regrutuje (naziv posla u odeljenju/direkciji,diviziji ili sektoru) **Departamenti i Patent Shoferit/ Departman za Vozačke dozvole**

Titulli i vendit të punës /Naziv radnog mesta: **Zyrtar/e Administrativ/e / Administrativni službenik/ca**

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës? **Niveli profesional 1 grada 10 (BKK 7), Funkcionalna kategorija i stepen radnog mesta/ Nivo upravljanja 1-stepen 10 (BKK 7),**

Numri i referencës së vendit të punës/Broj radnog mesta/ **RN00003664**

(Shënoni saktësisht por me pak fjale detyrat dhe përgjegjësitë kryesore)/(Naznačite tačno i kratkim rečima glavne odgovornosti):

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe zyrtarin e lartë harton planet e punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
- Ndihmon në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
- Merr pjesë në hartimin, zhvillimin e procedurave dhe dokumenteve tjera si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre në fushën profesionale specifike brenda afateve kohore të caktuara.
- Organizon dhe lehtëson takime, konferenca dhe ngjarje të tjera të veçanta, koordinon dhe merr pjesë në mbledhjet e komisioneve sipas rastit;
- Ofron ndihmë dhe mbështetje në zgjidhjen e problemeve, planifikimin dhe menaxhimin e projekteve, si dhe zhvillimin dhe zbatimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara të njësisë organizative;
- Kryen hulumtime dhe analiza mbi çështjet, temave të caktuara nga mbikëqyrësi ose staf i nivelit të lartë profesional dhe përgatit shkresa, raporte;
- Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave në fushat e interesit të përbashkët si dhe ofron përkrahje në fushën specifike profesionale për stafin e nivelit më të lartë profesional sipas kërkesës;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;
